



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë Bankë”

ofruar nga

Universiteti “Luarasi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

- 1. Prof.Dr Drini Salko**
- 2. Prof.Asoc.Dr Orkida Ilollari**

Janar /2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Financë Bankë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Luarasi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë-Bankë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Financë Bankë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr.483 datë 12.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.125, datë 16.05.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr.93.date 02.11.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite / 6 (gjashtë semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 7 PAE/ 14 PAK 2022-2023 7 PAE/ 11 PAK 2023-2024 8 PAE/ 14 PAK
18	Numri i studentëve per tre vitet akademike:	2019-2020 52 studentë 2020-2021 36 studentë 2021-2022 33 studentë 2022-2023 21 studentë 2023-2024 15 studentë
19	Komente / të tjera:	N/A



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Universiteti "Luarasi ", është liçensuar me VKM nr.611 datë 11.09.2003. UL ushtron veprimtarinë e tij në bazë të akteve ligjore, nënligjore dhe kuadrit rregullator të brendshëm të tij. Që nga kjo periudhë, UL ka zgjeruar aktivitetin e tij dhe sot në përbërjen e tij operojnë 3 Fakultete si njësi kryesore. Fakulteti i Ekonomisë (FE) si një nga këto tre fakultete është njëkohësisht dhe njësia kryesore përgjegjëse e programit Bachelor në Financë Bankë. FE ka në përbërje të tij 3 departamente ku Departamenti i Financë Bankë është njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi.

Programi i studimit Bachelor në Financë Bankë është hapur me UMASH nr.483 datë 12.10.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe është akredituar me kusht për herë të parë bazuar në Vendimin nr.24, datë 19.01.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Më tej me Urdhrin nr.433, datë 25.08.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve është miratuar plotësimi i kushteve të vendosura në Vendimin nr.24, të MAS.

Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e financës dhe bankës duke i specializuar në këto drejtime të tregut të punës të diplomuarit në këtë program. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale është tre vite akademike. Programi i studimit Bachelor në Financë Bankë është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*". Qëllimi i programit të studimit siç përcaktohet nga vetë institucioni është pajisja e studentëve me njohuri gjithëpërfshirëse mbi financën, bankën, me vendimmarrjen dhe mjetet e zbatimit të funksionit financiar, në të gjithë llojet e sipërmarrjes, institucioneve financiare, si dhe njohuritë mbi vlerësimin dhe investimin në tregun financiar. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Financë Bankës (DFB) që ofron programe studimi në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, e ka një eksperiencë relativisht të gjatë në lidhje me ofrimin e programeve në fushën e financës duke aplikuar e përfshirë në kurikulat e veta lëndë sipas kërkesave të tregut të punës. Duke analizuar përbërjen e stafit akademik të DFB vërehet se numri i këtij stafi gjatë 3 viteve të fundit nuk ka ndryshuar duke mbetur në 7 anëtarë stafi si PAE aq sa dhe është numri minimal i një strukture të tillë. Në vitin akademik aktual 2023-2024 departamenti ka në përbërjen e tij 8 PAE dhe 7 PAK. Personeli me kohë të plotë krahas angazhimit në mësimdhënie, është i përfshirë dhe në punë kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit ekonomik lokal/ kombëtar.

Departamenti i Financë Bankës, bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e mësimdhënies, organizimit të konferencave shkencore dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte të ndryshme. Departamenti bashkëpunon gjithashtu me institucione të tjera private dhe publike për arritjen e objektivave të tij në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përbërë nga **Prof. Dr. Drini Salko** dhe **Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari** dhe i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, u mbështet gjatë këtij procesi nga koordinatori teknik i ASCAL Msc. Arbri Ndreka. GVJ analizoi dokumentacionin e ofruar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe dokumente shtesë të dorëzuara nga institucionet përkatëse. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), rezultat i bashkëpunimit të stafit akademik dhe administrativ, përbënte një burim të rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm, duke reflektuar situatën aktuale të procesit të formimit dhe zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë (FE) dhe Departamentin e Financë Bankës (DFB). Gjatë vizitës në Institucion, më 22 dhe 23 tetor 2024, GVJ zhvilloi takime me drejtues të njësive kryesore dhe struktura të tjera të Universitetit të Luarasit (UL), duke shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin përkatës të akreditimit të programit. Takimet përfshinë intervista me hartuesit e RVB-së, anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), personelin drejtues, akademik dhe administrativ, si dhe studentët e programit Bachelor në “Financë-Bankë”. GVJ gjithashtu kreu një inspektim të detajuar të ambienteve të UL dhe të atyre që i shërbejnë këtij programi. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përmban gjashtë standarde kryesore, ku secili është analizuar në bazë të kriterëve përkatës. Çdo standard është vlerësuar në përputhje me të dhënat në RVB, evidencat shtesë dhe materialet e paraqitura gjatë vizitës. Ekspertët shqyrtuan ndryshimet e bëra dhe ndikimin e tyre në përmbushjen e standardeve. Për secilin standard, GVJ dha një vlerësim të qartë mbi përmbushjen e tij dhe një koment të detajuar. Raporti përfundon me një analizë përmbledhëse të pikave të forta dhe dobëta të programit Bachelor në “Financë-Bankë”.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv. Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.93, datë 02.11.2015 janë:

Programi i studimit Bachelor në Financë Bankë është akredituar me kusht për herë të parë bazuar në Vendimin nr.24, date 19.01.2016 te Ministrisë te Arsimit dhe Sporteve.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Bazuar në Urdhrin nr.433, date 25.08.2016 të Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve është miratuar plotësimi i kushteve të vendosura në Vendimin nr.24, të MAS.

Më datë 08.01.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.10 Prot., datë 08.01.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 17.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.10/1 Prot., datë 20.01.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Standardi II.1:Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

1. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin II.1, kriteri 2*, GVJ arsyeton se, pavarësisht pritjes për të marrë licensën për programin e me OUL/LSE nga ana e Institucionit, minimalisht disa lëndë duhet të ishin ndryshuar për brezin e studentëve të diplomuar në këto vite, të cilët nuk kishin pse të “penalizoheshin” për pritjen e licensës për këto ndryshime.
Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Standardi II.5 :Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

2. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin II.5*, GVJ arsyeton se, pavarësisht dinamikave të tregut, kjo nuk justifikon mungesën e një studimi të



plotë në funksion të studentëve të këtij programi. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Standardi III.1: Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve

3. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin III.1*, GVJ arsyeton se pasurimi i bibliotekës në të ardhmen nuk justifikon faktin e mospasjes fizikisht të dy literaturave të detyrueshme dhe ato që gjendeshin aty, kishin literaturë të vjetëruar. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 : Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

4. Lidhur me komentet e institucionit për *Standardin IV.1*, GVJ arsyeton se, duke qenë se numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program nuk ka qenë i qëndrueshëm dhe se raporti PAE/PAK (%) në përqindje për vitin akademik 2021-2022 ka qenë 63.2% / 36.8%. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.4 : Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

5. Lidhur me komentin e institucionit për *Standardin V.4*, GVJ arsyeton se nevojiten analiza mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve, analiza të cilat japin ndihmë në përmirësimin e programit të studimit Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.3: Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.



6. Lidhur me komentin e institucionit për *Standardin VI.3*, GVJ arsyeton se nevojiten raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik, si dhe vlerësimi i performancës së këtij stafi, të jenë të detajuara me analiza statistikore për të evidentuar çdo mangësi që del nga ky proces. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe: *Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DFB	Departamenti i Financë Bankë
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
FB	Financë Bankë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
UL	Universiteti Luarasi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë-Bankë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit Luarasi (UL), evidenca 1.1, kreu V “Organizimi i studimeve në Fakultetin Ekonomik” neni 29, rregullores së Departamentit Financë Bankë si dhe Rregullores së Programit të studimit, Bachelor në Financë Bankë” kreu I, neni 2. konstatohet se ky program nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi bazohet në Statutin e institucionit si dhe përkon edhe me zhvillimin institucional, akademik dhe shkencor të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të UL dhe strategjia e kërkimit shkencor për periudhën 2022-2026 të cilës i kanë paraprirë dy strategjitë, ajo mbi zhvillimin dhe strategjia e kërkimit shkencor dhe atë të mësimdhënies për vitet 2017-2022. Studentët që përfundojnë këtë program kanë mundësi që në kuadër të zhvillimeve ekonomiko sociale të dekadës së fundit të jenë pjesë e tregut të punës, kryesisht në sektorin e financës dhe bankës duke kontribuar në nivel lokal, rajonal apo edhe kombëtar në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor “Financë Bankë”</i> <i>Evidencë nr.1. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr. 13. Plani strategjik i zhvillimit të UL 2021-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar në evidencën 1.4, Statutit të Universitetit Luarasi, neni 3, u evidentua se misioni i UL-së, lidhet, midis të tjerash, me zhvillimin e dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Misioni i Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë Bankë” është përgatitja e specialistëve me njohuritë bashkëkohore në këto fusha. <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor “Financë Bankë”</i> <i>Evidencë nr.1. Statuti i UL</i>



	<i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr. 13. Plani strategjik i zhvillimit te UL 2021-2025</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në FB që ofrohet nga UL është bazuar në Statutin e institucionit, rregulloren e brendshme të tij si dhe planin strategjik të miratuar. Ky program është në funksion të zbatimit të vizionit, prioritetëve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e zhvillimit të UL (Objektivat strategjike të universitetit faqe 7). <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Finance Banke"</i> <i>Evidencë nr.1. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr. 13. Plani strategjik i zhvillimit te UL 2021-2025</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Organizimi i UL, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit të studimit Bachelor në "Financë Bankë", duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë Bankës që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Referuar tabelës 1 për stafin akademik të Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit të studimit rezultoi se kjo njësi ka në përbërje të saj 3(tre) departamente me një numër staf akademike që gjatë 3(tre) viteve të fundit akademik ka qënë i pandryshueshëm në 21 PAE, ndërsa numri i PAK ka qënë 32 anëtarë për vitin akademik 2021-2022, për vitin 2022-2023 ka qënë 31 anëtarë dhe për vitin aktual 2023-2024 19 anëtar. Numri i personelit ndihmës akademik ka qënë për të tre këto vite 2 anëtarë. Rezultoi se institucioni ka përvojën dhe burimet për ofrimin e një programi në fushën e studimit të Financës dhe Bankave. Departamenti Financë-Bankë si njësi bazë e programit të studimit Bachelor në "Financë Bankë", bazuar në tabelën nr 1, 2 të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik që përbëhet nga: 7 PAE, numër ky minimal i kërkuar për një njësi bazë, ndërsa PAK ka qënë në ulje respektivisht 14, 11 dhe 7 anëtarë. <i>Evidencë statistikore Tabelat përmbledhëse nr.1 dhe 2 në RVB</i>

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Sipas evidencës nr.9 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë (FE), kreu V neni 25,27,28, 29 si dhe evidencës 18 të rregullores së departamentit Financë Bankë, kreu III neni 8,9 vihet re se ky departament për vitin akademik aktual 2023-2024 ofron këtë program studimi të nivelit Bachelor në fushën e financës dhe bankës dhe një program studimi të nivelit Master i Shkencave. Programet e studimit organizohen në dy nivele: Ciklin e Parë dhe të Dytë. Departamenti i Financë Bankë në UL, synon të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare brenda dhe jashtë vendit. Mbështetur dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), konkludojmë se programi i studimit Bachelor në “Financë Bankë”, mban numrin 6 të kornizës europiane (dhe shqiptare) të kualifikimit. Gjithashtu, institucioni ka kryer edhe kodifikimin e programit të studimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Bachelor në “Financë Bankë”, përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e këtij programi studimi. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Financë Bankë”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor “Finance Banke”</i> <i>Evidencë nr.1. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë statistikore në RVB</i>		
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në Financë Bankë është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UL duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare dhe në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X




Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Mbështetur në Rregulloren e UL-së në Kreun IV dhe V si dhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu II neni 5, Kreu III neni 6,7,8,9,10,11 si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), theksojmë se institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Në këto dokumente janë të përcaktuar qartë drejtimit e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësisë të gjitha njësive përkatëse. <i>Evidencë nr.1. Statuti i UL</i> <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit të studimit Bachelor "Finance Banke"</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Sipas listës së bashkëpunimit ndërinstitutional të Universitetit Luarasi bazuar në tabelën përmbledhëse statistikore të RVB nr. 5 dhe evidencën nr.21 si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, UL ka 32 marrëveshje bashkëpunimesh me aktorë të biznesit, institucione publike dhe private, bashkëpunime ndërinstitutionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit. Studentët mund të lëvizin në kuadër të projekteve të ndryshme, ku UL është palë. <i>Evidencë nr.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> <i>Evidencë statistikore në RVB, Tabela nr.5</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Bazuar në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes UL dhe institucioneve të tjera apo aktoreve të sipërmarrjes shikojmë se një numër i konsiderueshëm e tyre ofrojnë mundësinë e realizimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi. Ky numër marrëveshjesh plotëson edhe qëllimin e realizimit të praktikës profesionale të studentëve të këtij programi. Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi

praktikave të punës apo stazhit etj.	i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve. <i>Evidencë nr.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> <i>Evidencë statistikore në RVB, Tabela nr.5</i> <i>Evidencë nr. 22.Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimi 2018-2022</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar listës së bashkëpunimit ndër-institucional, raportit të vlerësimit të brendshëm, njësia përgjegjëse në funksion të realizimit të programit të studimit, Bachelor në “Financë Bankë”, mban evidenca dhe analizon përfitimet nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këto analiza janë pjesë e raporteve vjetore në rang institucioni dhe njësie kryesore (FE) <i>Evidencë nr.17.Raport vjetor për vitin akademik 2022-2023 i UL</i> <i>Evidencë nr.21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> <i>Evidencë nr.23.Raporti vjetor FE</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në “Financë Bankë”, bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UL dhe institucioneve publike apo private si dhe sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar realizimin e praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialistë të fushës jashtë institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve




Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Financë Bankë” që ofrohet nga DFB i Fakultetit të Ekonomisë pranë UL është i organizuar në 31 module (përfshirë praktikën profesionale) të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë. Programi bazohet në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjës. Programi me një kohëzgjatje 3 vite akademike e ndarë në 6 semestra dhe që përfshin 180 ECTS. <i>Evidencë nr.25/Plani mësimor i programit të studimit Tabelat përmbledhëse statistikore të RVB (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës dhe bankës. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në financë apo pranë bankave brenda hapësirës së njohurive të një programi Bachelor si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre. <i>Megjithatë, vërejmë që gjatë 3 viteve akademike të fundit në këtë program nuk janë bërë ndryshime të mundshme brenda kufirit 20 % që është kompetencë e institucionit. Në këtë kontekst në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mësimnxënies nga ana e studentëve dhe të reflektohen ndryshimet në tregun e punës dhe zhvillimeve ekonomiko-financiare, do të sugjerohet disa rregullime kryesisht teknike që përmirësojnë me tej përmbajtjen e programit të propozuar. Kështu:</i> 1. Bazuar në fushën e programit me fokus financën dhe bankën në vitin e parë semestri i II-të mund të përfshihet lënda “Baza të Financës”. Studentët tashmë në vitin e parë dhe në semestrin e I-rë marrin njohuritë bazë të kontabilitetit në lëndën me këtë emër dhe në semestrin e II-të marrin njohuritë bazë të financës, Kështu, këto njohuri janë një ndihmesë në formimin më të plotë në fushën e financës që zhvillohet me lëndët vijuese. 2. Në program të mund të zinin më shumë peshë njohuritë në financë dhe bankë duke e lehtësuar programin nga lëndë të kontabilitetit që në total janë 5 të tilla apo të menaxhimit. Në funksion të këtij qëllimi mund të bëhen edhe rregullime si më poshtë vijon:




	- <i>Modulet "Kontabilitet Kosto " dhe Kontabilitet Drejtimi" mund të jenë një modul i vetëm dhe mund të shtohet lënda "Kontabilitet Bankar" si një lëndë e drejtpërdrejtë për bankat.</i> - <i>Të shihet mundësia e axhustimit të një nga tre lëndët vijuese, Lënda "Menaxhim Strategjik", Menaxhim Operacionesh dhe "Drejtim Marketingu" dhe të mund të përfshihet një lëndë bashkëkohore me fokus Fintech apo Digjitalizimin bankar si një trend i rëndësishëm i zhvillimit të viteve të fundit në sektorin bankar.</i> - <i>Lënda "Drejtim Portofoli" ofron njohuri të cilat përgjithësisht trajtohen në programet e studimit të ciklit të dytë në nivelin Master. Njohuritë për këtë nivel programi studimi i mbulon lënda "Tregjet dhe Institucionet Financiare" e cila zhvillohet në të njëjtën semestër dhe që ofron njohuri edhe për instrumentet financiare.</i> - <i>Bazuar në rëndësinë e lëndëve me zgjedhje që i krijojnë mundësi studentit të "profilizohet" më shumë në financë apo bankë do ishte më mirë të rritej numri i lëndëve me zgjedhje edhe në semestrin e parë të vitit të tretë gjë që do plotësonin më mirë përmbajtjen e programit;</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.11.Rregullore e programit të studimit Bachelor në FB</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Tabelat përmbledhëse statistikore të RVB (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni "Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese", Tabela nr.9. evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, datë 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë: Lëndët e kategorisë A zënë 18.8 % të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 20 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë B zënë 54.4 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 55 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë C zënë 11.8 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë D zënë 11.6 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri; Lëndët e kategorisë E zënë 3.3 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 5 % që është kriteri;

	Bazuar në kriteret e miratuara për një program Bachelor shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura. <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.11.Rregullore e programit të studimit Bachelor në FB</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Tabelat përmbledhëse statistikore të RVB (tabela nr. 9)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit është mbështetur në plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore përfshin si komponent më vete praktikën profesionale e cila zhvillohet menjëherë pas përfundimit të procesit mësimor dhe përpara diplomimit të studentëve. Praktika profesionale në planin mësimor është e planifikuar me 75 orë totale dhe me 3 kredite (sistemi ETCS). <i>Bazuar në rëndësinë që ka ky komponent i programit, mendojmë se duhet të ketë më shumë kredite si dhe ngarkesën e orëve totale të realizimit të saj.</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.30.Udhezues për zhvillimin e lëndës së praktikës</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Tabelat përmbledhëse statistikore të RVB (tabela nr. 10)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Institucioni mbështetur në kërkesat dhe kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi ka hartuar “Rregullorja e Studimeve në UL”. Në këtë dokument janë të përcaktuara procedurat dhe fazat e procesit të pranimit vlerësimit, transferimit dhe financimit të studentëve. Në këtë program nuk ka pasur praktikë pranimi dhe financimi të studentëve me status të veçantë. <i>Referenca:RVB dhe vizita në institucion</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	UL ofron vetëm këtë program studimi në Bachelor në FB. Nga informacioni që GVJ ka, rezulton se programi Bachelor me këtë emërtim zhvillohen në disa prej në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri. Kështu Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti European apo Universiteti Barleti janë institucione të arsimit të lartë që ofrojnë këtë program studimi. Përmbajtja e programit duke marrë për bazë fushën e financës në kuadër të gjerë përmban në pjesën më të madhe lëndë që zhvillohen në këto programe të ngjashme të nivelit Bachelor nga të gjitha universitetet që ofrojnë programe në fushën e financës.




	<i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Tabelat përmbledhëse statistikore të RVB (tabela nr. 10)</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi është në proces kodifikimi në kuadër të zbatimit të VKM nr.310 datë 11.05.2022” Ashtu siç e kemi theksuar me lartë, UL ka bërë kërkesën për kodifikim të një numri programesh që zhvillohen pranë MASR këtë vit kalendarik me nr.prot.76 datë 29.03.2023 dhe këto kode i ka referuar në sistemin Pitagora. <i>Evidencë nr.19.Shkresa e UL. Përcillen kodifikimet e programeve</i> <i>Evidencë nr.32.Udhezues për përdorimin e platformës Pitagora</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi Bachelor në Financë Bankë aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në Financë Bankë organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e GVJ në kriterin nr.2 dhe 4 të këtij standardi do i shërbenin këtij procesi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe	FE si njësia kryesore e këtij program studimi përmbush detyrimet ligjore në organizim, strukturë dhe staf akademik. Kjo njësi përbëhet nga tre Departamente që aktualisht zhvillojnë 6 programe studimi të nivelit Bachelor dhe Master: Departamentin e Administrim Biznesit; Departamentin e Financë Bankë; Departamentin e Ekonomiksit;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

strukturën akademike,
stafet akademike
vlerësimin dhe
akreditimin.

Stafi akademik sipas departamenteve për vitin aktual akademik
2023-2024 është si më poshtë vijon:

Departamenti i Administrim Biznesit:

- 7 PAE, dhe 4 PAK;

Departamenti i Financë Bankë:

- 7 PAE, dhe 7 PAK;

Departamenti i Ekonomiksit:

- 7 PAE, 8 PAK;

Departamenti Financë Bankë si njësi bazë që mbulon këtë
program studimi i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara.
Njësia bazë, Departamenti i Financë Bankë përgjegjës për
programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe
shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve
akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	-	1	-	-
Prof. Asoc.	1	2	1	2	-	4
Dr./PhD.	4	4	3	4	3	2
Msc.	2	7	3	4	5	1
Totali	7	14	7	11	8	7

DFB ka në strukturën e tij edhe 2 laborantë si staf ndihmës
akademik. Shihet se DFB plotëson kërkesat ligjore në fuqi
lidhur me strukturën akademike të stafit duke patur numrin
minimal të lejuar për funksionimin e një njësie bazë.

*GVJ rekomandon që institucioni duhet të synojë rritjen e
numrit të PAE me staf akademik më të kualifikuar që të
zotërojnë tituj akademik Prof.Dr. apo Prof.Asoc.Dr. gjë që do
i shërbejë edhe për të mbuluar programet e studimit të nivelit
te dytë Master.*

*Referenca :Tabelat përmbledhëse statistikore te RVB (tabela
nr. 1dhe nr.2)*

Kriteri 2. Njësia
kryesore/bazë përgjegjëse
për programin e studimit

Realizimi i praktikave profesionale bazohet në marrëveshjet që
FE apo UL ka me institucione apo sipërmarrje të ndryshme

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	duke angazhuar në këtë proces edhe PAE me planifikim ngarkese mësimore për ta. DFB ka në strukturën e tij edhe 2 laborantë si staf ndihmës akademik. Gjithashtu, koordinatori i programit është edhe personi përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve. <i>Referenca :Tabelat përmbledhëse statistikore te RVB (tabela nr. 1dhe nr.2)</i> <i>Evidencë nr.18 Rregullore e Departamentit të Financë Bankë</i> <i>Reference nr.40.Lista e praktikave profesionale të studenteve</i> <i>Takim i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në rregulloren e Departamentit të FB dhe rregulloren e këtij programi, Përgjegjësi i kësaj njësie bazë është edhe në rolin e koordinatorit të programit. Gjithashtu, koordinatori i programit organizon edhe praktikat profesionale të studentëve. <i>Referenca nr.11.Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.18 Rregullore e Departamentit të Financë Bankë</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se njësia kryesore FE dhe njësia bazë Departamenti FB të programit të studimit Bachelor në FB plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë si për njësinë kryesore ashtu edhe për atë bazë lidhur me numrin e personelit akademik me kohë të plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga FE si njësi kryesore dhe DFB si njësi bazë si dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe janë të aksesueshme nga gjithë stafi akademik. Ky

organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	informacion përfshin të dhëna të plota të programit si dhe gjithë bazën rregullative në nivel institucioni, fakulteti departamenti dhe programi. Ky informacion është i aksesueshem nëpërmjet platformës "Share point" të Microsoft. Gjithashtu UL në bazë të marrëveshjes me RASH aplikon platformën PITAGORA që jep mundësi aksesit në informacion e procesit mësimor për stafin dhe studentët. <i>Evidenca nr.42.Marrëveshja e UL me RASH date 26.05.2022</i> <i>Evidencë nr.44.Udhezues për përdorimin e strukturës IT "Moodle Teams tutorjale</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i programit të studimit vërejmë se ai jep të gjithë informacionin e nevojshëm me elementet përkatës të tij si ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij, ndjekjen e programit (me kohë të plotë) si dhe vlerësimin e dijeve. Në mbështetje të programit janë edhe rregulloret përkatëse në nivel institucioni fakulteti departamenti si dhe të vete programit. Po ashtu në rregullore të veçanta jepen modalitetet dhe kriteret e regjistrimit të studentëve potencial në këtë program si dhe transferimet nga jashtë apo brenda të studimeve në këtë program. <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.27.Praktika e miratimit të programeve dhe planeve mesimore:</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor ka hartuar bazën rregullatore lidhur me procesin përcaktimit të kriterëve të përgjithshme apo specifike lidhur me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve apo studentëve. Në funksion të këtij procesi është rregullorja e studimeve të UL dhe rregulloret e tjera në nivel njësie kryesore (FE) dhe njësie bazë (DFB). Gjatë vizitës në institucion pranë zyrës së sekretarisë mësimore, GVJ evidentoi raste transferimi studentësh i bazuar në procedurat e miratuara. <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.18.Rregullore e Departamentit Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Finance Banke"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo	Nga shqyrtimi i programit të studimit rezultojnë se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :




orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	• Emërtimi i lëndës/ modulit; • Viti/ semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse; GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DFB u evidentua diskutimi dhe axhustimi programit në mënyre periodike në fillim të vitit brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës. Nga ana tjetër, GVJ evidenton që gjatë viteve të fundit nuk janë bërë ndryshime në program qoftë edhe brenda kufirit prej 20 % që është kompetenc e institucionit pa prekur brendinë e programit. <i>GVJ mendon që zhvillimet e 4-5 viteve të fundit në ekonomi e bëjnë të domosdoshme përmirësimin e programit në funksion të këtyre ndryshimeve ku me vlerë janë edhe rekomandimet tona të dhëna me sipër.</i> <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i>





	<i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FB është i detajuar me të gjithë elementet përkatës, si dhe i strukturuar dhe organizuar për të plotësuar objektivat formues të tij. Përmbajtja e lëndëve/moduleve të programit përgjithësisht janë me të gjithë elementet përkatës por edhe në përmbajtjen e tyre. GVJ sugjeron që në kuadër të zhvillimeve të tregut financiar e bankar gjatë viteve të fundit të realizohen përmirësime në program të paktën deri në kufirin e 20 % të krediteve të programit bazuar edhe në rekomandimet e GVJ të dhëna më lart në standardin II.1.kriteri 2.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi në emërtim dhe përmbajtjen e tij ofron tiparet e një program studimi të nivelit Bachelor në fushën e financës dhe bankës. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në treg. Emërtimi dhe përmbajtja jo vetëm u mundëson punësimin në përfundim të studimeve në financë apo bankë, por të diplomuarit në këtë program mund të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve Master në një spektër me të gjerë të financës, kontabilitetit dhe auditimit. <i>Evidencë nr.2.Rregullore e brendshme e UL</i> <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në të katër drejtimet e tij. Duke analizuar programin shohim që studentët: - Në vitin e parë marrin njohuritë bazë makro dhe

kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	mikroekonomike, matematike, statistike dhe konceptet në kontabilitet të domosdoshme për çdo program të fushës së ekonomisë; - Në vitin dytë në disa nga lëndët që zhvillohen merren njohuri të menaxhimit por edhe të fushave bazë të financës dhe bankës etj; - Në vitin e tretë programi ofron njohuri me specifikë lidhur me financën, bankave, drejtimit financiar dhe atë të riskut etj, të cilat krahas praktikës profesionale finalizohen me detyrimet përmbyllëse; Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Financë Bankë"</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencë të gjatë të DFB. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare dhe bankare. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Finance Banke"</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lëndëve karakterizuese të programit shohim që në to një pjesë e temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e lëndëve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i>



	<i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Financë Bankë"</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lëndëve të këtij programi të prezantuar nga institucione, vërejmë se në pjesën më të madhe të tyre ka përditësim të njohurive bazuar në literaturë detyruese dhe ndihmëse të botuar gjatë viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DFB dhe atë të programit gjatë vizitës në institucion, ne e vërtetësojmë përditësimin e leksioneve të përgatitura nga stafi akademik. Në programet e lëndëve u vërtetësojmë që në shumicën e tyre literatura e rekomanduar të jetë e viteve të fundit. <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Financë Bankë"</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programeve realizon përfitimet e dijeve dhe aftësive të studenteve për një program bachelor në FB. Programi i studimit përfshin trajtimin fillimisht të lëndëve bazë me formim mikro dhe makroekonomik dhe që në vitin e parë përfshihen lëndët e përgjithshme në fushën e financës dhe kontabilitetit për tu pasuar në vitet e tjera me lëndë kryesisht profesionale në fushën e programit. Programi i studimit kombinon si trajtimin teorik ashtu edhe atë aplikativ sidomos në lëndët e financës. <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Financë Bankë"</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Përmbajtja e programit është e tillë që nëpërmjet njohurive të marra në të dy drejtësitë e tij (financë dhe bankë) të bëjë të mundur për studentët e diplomuar vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programit Master. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në këto drejtësi. Specifikimi që në emërtim i këtyre dy drejtësive është përparësi në mundësinë e punësimit të të diplomuarve dhe kjo sidomos në tregun financiar e bankar. <i>Evidencë nr.14.Syllabuset e programit</i> <i>Evidencë nr.25.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.11.Rregullore e programit Bachelor "Financë Bankë"</i>
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi</i>




	studimit Bachelor në FB përmbush objektivat formuese të tij dhe nivelin kualifikues sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve duke mundësuar studentët e diplomuar për tu punësuar në tregun financiar dhe atë bankar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	DFB si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij program bazuar në marrëveshjet institucionale me aktoret e tregut të punës bën përpjekje në përmirësimin e programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program ne e vërtetojmë që përmirësimet në program kanë qenë kryesisht në kuadrin e lirisë akademike të stafit nëpërmjet rifreskimit të literaturës. Nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program e vërtetojmë përmirësimin në ciklet e leksioneve të lëndëve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me tregun financiar dhe atë bankar. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të UL shohim se mungon një studim i tregut të punës i viteve të fundit që do të orientonte më mirë gjithë procesin e aplikimit, zhvillimit të programit dhe orientimit për punësim të diplomuarve. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit për vitet 2021-2025, por në të nuk ka referim të plotë të tregut të punës.</i> <i>Evidencë nr.13.Plani Strategjik i Zhvillimit 2021-2025</i> <i>Vizita në institucion e GJV dhe takim me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Diskutimi dhe opinion i studentëve rreth programit mësimor dhe mësimdhënies realizohet nëpërmjet diskutimeve me pedagogun e lëndës por edhe nëpërmjet instrumentit të vlerësimit nëpërmjet anketimeve që ruajnë anonimitetin e tyre që ata bëjnë për lëndën dhe pedagogun përkatës. Institucioni mban kontakte me studentët e diplomuar ku Zyra e Karrierës dhe Alumni përgjegjëse për këtë lidhje kontaktojnë me të diplomuarit. Edhe këshillat studentore të zgjedhura janë pjesë e këtij procesi.

	<i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin akademik dhe studentet</i> <i>Evidencë nr.57.Formular vlerësimi nga studentet për pedagogun</i> <i>Evidencë nr.58.Raport mbi pyetësorët e studenteve</i> <i>Evidencë nr.123.Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Ashtu siç edhe e kemi theksuar me lart përmirësimet në program janë kryesisht në përmbajtjen e syllabuseve si dhe në funksion të lirive akademike që ka stafi i këtij programi ku padyshim synohet të reflektohen edhe zhvillimet e fundit në tregun e punës. <i>Gjithsesi një analize e drejtpërdrejtë e tregut të punës lidhur me këtë program do të bëjë që edhe ndryshimet e mundshme të jenë të karakterit të përmbajtjes dhe rritjes së cilësisë në funksion të këtij tregu.</i> <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin akademik dhe studentet</i> <i>Evidencë nr.123.Rregullore e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit dhe vlerësimit të programit plotëson standardet e kërkuara duke qenë premisë në përmirësimin e tij në të ardhmen. GVJ sugjeron që të realizohet një studim i plotë i tregut të punës me fokus tregun potencial për tu punësuar në sektorët e financës, bankës, sistemit tatimor e doganor dhe kontabilitete për studentët e këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", planin mësimor dhe syllabuset, u vërejt se format kryesore të punës mësimore në Fakultetin e Ekonomisë (FE), Departamenti i Financë-Bankë, në Universitetin e Luarasi (UL) janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe temat e diplomës. Sipas planit mësimor, orët mësimore në auditor dhe angazhimi individual i studentëve janë përcaktuar sipas të gjitha elementeve të një programi të nivelit "Bachelor". <i>Evidencë nr.25. Planet mësimore 2020-2021; 2021-2022;2022-2023</i> <i>Evidencë nr. 14 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë (FE) dhe programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", ka një personel akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në procesin mësimor, duke iu përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve. Megjithatë, gjatë takimit me studentët e këtij programi, GVJ vërejt se shpesh studentët mbështeteshin vetëm te prezantimet në formë PPT të përgatitura nga pedagogët, pa shfrytëzuar literaturën e detyrueshme. Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ konstatoi se literatura e detyrueshme për lëndët "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Paraja dhe Bankat," të përgatitura nga pedagogu, mungonte fizikisht. <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentët e programit.</i> <i>Evidencë nr.25. Planet mësimore 2020-2021; 2021-2022;2022-2023</i> <i>Evidencë nr.14 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca nr.48 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies</i> <i>Evidenca nr.63 Biblioteka online</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin	Në përputhje me rregulloren dhe programeve të studimit të Fakultetit të Ekonomisë (FE) si dhe të programit të studimit të

akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	ciklit të parë Bachelor në “Financë Bankë”, UL organizon trajnime për pedagogët, duke përfshirë si ata të rinjtë ashtu edhe ata me përvojë të gjatë, me fokus në përmirësimin e didaktikës në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Gjithashtu, UL ofron mundësi për zhvillim të mëtejshëm profesional, duke trajnuar pedagogët në metoda të reja dhe inovative të mësimdhënies, si dhe duke i përfshirë në shkëmbimet e programit Erasmus. <i>Evidenca nr. 65 Modul Trajnimi Academic Writing Skills</i> <i>Evidenca nr. 67 Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik që mbulon këtë program disponon eksperiencën dhe kualifikimet e nevojshme për të siguruar një proces mësimdhënieje të suksesshëm. Nga CV-të e stafit akademik, konstatohet se shumica kanë një formim të fortë akademik dhe profesional në fushat e Financës dhe Bankës, si dhe në lëndët përkatëse që mbulojnë këto drejtime. Gjatë takimit me studentët e këtij programi, u evidentua një bashkëpunim i frytshëm dhe i ndërsjellë midis tyre dhe personelit akademik. <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentët e programit.</i> <i>Evidencë nr.25. Planet mësimore 2020-2021; 2021-2022;2022-2023</i> <i>Evidencë nr.34 CV e stafit akademik 2020-2021; 2021-2022;2022-2023</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Departamenti i Financë-Bankë, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kryen një vlerësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimet nga eprorët, monitorimin e procesit mësimor dhe feedback-un nga studentët. Gjatë vizitës së GVJ në UL, u konstatua se vlerësimi dhe monitorimi i aftësive pedagogjike të stafit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike. NJSBC fokusohet në implementimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësim, përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit, si dhe në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu, NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, shqyrton modele të
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që	





promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	ndryshme dhe vlerëson aktivitetet që lidhen me shërbimet akademike dhe administrative. <i>Evidenca nr 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi", nr. 17 2023.</i> <i>Evidenca nr 50. Vendim i Senatit "Për Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 57. Formular vlerësimi nga studenti për pedagogun dhe lëndën</i> <i>Evidenca nr 71. Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit akademik</i> <i>Evidenca nr 73. Raportet vjetore të NJBSC 2021-2022, 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>Sa i përket standardit III.1, GVJ vlerëson se stafi akademik është i kualifikuar dhe i përkushtuar për të mbështetur studentët. UL ofron trajnime për pedagogët me qëllim modernizimin e metodave të mësimdhënies. Gjatë vizitës së GVJ-së në bibliotekë, u vu re se literatura e detyrueshme ishte e vjetëruar, dy prej materialeve mungonin fizikisht dhe nuk u identifikuan leksione shtesë me literaturë bashkëkohore të përgatitura nga pedagogët e këtij programi për të plotësuar boshllëqet e literaturës së vjetër.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e	Në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", syllabuset e lëndëve përkatëse përcaktojnë format e kontrollit të dijeve të studentëve. Në programet e lëndëve të këtij programi, specifikohet qartë mënyra e vlerësimit për secilën lëndë, duke përfshirë përbërësit e vlerësimit, përqindjet e secilës pjesë dhe sqarimet përkatëse.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregulloren të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga vëzhgimi i disa syllabuseve nga GVJ, u konstatua se kishte ndryshime në formate dhe përqindjet e vlerësimit për disa lëndë të caktuara. <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 11. Rregulloren e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë e miratuar me VSA nr.1/2024</i> <i>Evidenca 18. Rregulloren e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 9. Rregulloren e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në syllabusin e pedagogëve për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", u vërejt se pedagogu i secilës lëndë bën një prezantim të përmbajtjes së lëndës, objektivave, temave testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe elementëve të tjerë të syllabusit gjatë javës së parë të mësimit. <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 75. Java e orientimit për studentet e rinj.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke u bazuar në syllabuset e lëndëve, u vërejt se kontrolli i dijeve realizohet gjatë procesit mësimor përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në leksione, seminare, detyra kursi, si dhe në provimet e ndërmjetëm dhe përfundimtar. Në programet e lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", specifikohet qartë mënyra e vlerësimit, përbërësit e tij dhe përqindjet përkatëse. <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Gjatë vizitës së GVJ në UL dhe takimit me studentët dhe pedagogët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë", u konstatua se ata ishin në një komunikim të drejtpërdrejtë për të përmirësuar metodat e mësimdhënies. Po ashtu, forma e vlerësimit nga studentët për pedagogët dhe monitorimet e procesit mësimor ofronin mundësi për përmirësimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies. <i>Vizita në institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentët e programit.</i> <i>Evidenca nr 57. Formular vlerësimi nga studenti për pedagogun dhe lëndën.</i>




	<i>Evidenca nr 71. Raport mbi vëzhgimin e paparalajmëruar të stafit akademik.</i> <i>Evidenca nr 73. Raportet vjetore të NJBSC 2021-2022, 2022-2023.</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Sipas rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë Bankë”, metodat e mësimdhënies inkurajojnë autonominë e studentëve. Mësimdhënia bazohet në format tradicionale si leksionet, seminarët, praktikat e lëndës, temat e diplomës dhe provimi përfundimtar. UL gjithashtu ofron mundësinë, përmes rregullores së tutoriatit, që studentët të konsultohen me pedagogët mbi çështje të ndryshme akademike që mund t’u lindin. <i>Evidenca 48. Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies.</i> <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 76. Rregullore tutoriati në rang universiteti</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe vizitës së realizuar, konkludon se UL ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural për vlerësimin e dijeve të studentëve gjatë procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në	Duke u bazuar në rregulloren e provimeve, u konstatua se kontrolli i dijeve realizohet gjatë procesit mësimor, në provimin e ndërmjetëm dhe në provimin përfundimtar, siç është parashikuar në çdo syllabus të lëndëve. Vlerësimi final për çdo student është një mesatare e ponderuar e vlerësimeve të këtyre fazave. Kjo metodë vlerësimi ofron mundësinë që studentët të angazhohen gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të kontributit të tyre, si në auditor ashtu edhe jashtë tij.




syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë</i> <i>"Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Format e testimit dhe vlerësimit janë të kombinuara, duke përfshirë si provime me shkrim ashtu edhe me gojë, sipas rregullores së provimeve të Universitetit Luarasi. Gjatë vizitës së GVJ në UL, u prezantua gjithashtu platforma "Moodle Luarasi LMS," e cila ofron mundësinë për studentët të marrin vlerësimet e tyre përmes kësaj platforme. <i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Për programin e ciklit të parë Bachelor në Financë Bankë," vlerësimet përfundimtare të lëndëve realizohen në përputhje me syllabuset, të cilat janë hartuar në bazë të Vendimit nr. 879, datë 18/12/19. <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në</i> <i>Financë Bankë.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në përputhje me rregulloren e programit të studimit ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë studentët informohen dhe këshillohen vazhdimisht për të përmirësuar ecurinë e tyre akademike. Sipas rregullores së provimeve, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përfshin seanca rishikimi për provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, ku pedagogët ofrojnë komente dhe feedback për studentët. <i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Sipas rregullores së provimeve dhe të programit të studimit ciklit të parë Bachelor në Financë Bankë, komisioni përgjegjës për administrimin e provimeve ndalon kopjimin gjatë provimeve dhe detyrave. <i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë</i> <i>"Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas rregullores institucionale, rregulloreve të provimeve dhe programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë Bankë, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritat e përcaktuara nga aktet rregullatore institucionale. Rezultatet e provimeve publikohen brenda një periudhe prej 10 ditëve të punës pas provimit me shkrim.




	Sistemi i përdorur është "Pitagora", ku studentët informohen për rezultatet e tyre. <i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas statutit të Universitetit Luarasi dhe rregullores së provimeve, rezultatet paraprake të provimeve kalojnë në sistemin e Pitagorës. Pasi studentët marrin rezultatet, ata kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e provimeve në bashkëpunim me stafin akademik përgjegjës. Nëse pas këtij procesi ka ndryshime në vlerësim, rezultatet kalojnë në një procesverbal dhe i bashkëngjiten tezës përkatëse. Në rastet e ankimimit të rezultateve, sipas rregullores së ankimimeve, studentët i drejtohen Departamentit të Financë-Bankës, i cili formon një komision për të shqyrtuar ri-vlerësimin e provimit.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<i>Evidenca 1. Statutit i Universitetit "Luarasi" nr. 502-2023</i> <i>Evidenca 77. Rregullore e provimeve.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 33. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga studenti</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë	Bazuar në planin mësimor të programit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë" vihet re që programi garanton përvetësimin e thelluar të njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale e shkencore të studentëve në fushën e financave

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	dhe bankave. Duke u mbështetur te syllabuset/modulet që ofron programi, si dhe te përfshirja e praktikës profesionale, programi ka si objektiv kryesor formimin teorik, profesional dhe relativisht shkencor të studentëve. <i>Rekomandohet që lëndët e profilit bankë dhe financë të kenë ngarkesë më të madhe orësh krahasuar me lëndët e kontabilitetit, për të pasqyruar më mirë emërtimin e vetë programit.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë Bankë".</i> <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar programit të ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë" dhe syllabuseve të lëndëve, vihet re zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, aftësive humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. Njëkohësisht, disa lëndë të programit ofrojnë trajtim të konsiderueshëm të aftësive për menaxhimin e informacionit përmes analizës së rasteve studimore. <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidencë 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në programin e studimit Bachelor në "Financë Bankë", kompetencat dhe aftësitë e studentëve analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës, duke u bazuar në formate të përcaktuara qartë nga syllabus-et. Pedagogët, që në javën e parë, prezantojnë objektivat dhe elementët kryesorë të lëndës, duke orientuar studentët për përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse. Kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes aktive në leksione, seminare dhe detyra kursi, si dhe në provimet ndërmjetëse dhe përfundimtare. Gjatë monitorimeve, u evidentua një komunikim i hapur midis pedagogëve dhe studentëve për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, ndërkohë që vlerësimi dhe monitorimi i procesit mësimor ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të studentëve. Rregullorja e programit nxit gjithashtu autonominë e studentëve dhe mundëson konsulta me pedagogët për të adresuar sfidat akademike.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e	




marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në Fakultetin e Ekonomisë (FE), Departamenti i Financë-Bankë, në Universitetin e Luarasi (UL), mësimdhënia bazohet në kombinimin e leksioneve, seminareve, detyrave të kursit dhe temave të diplomës, duke respektuar standardet e programit "Bachelor". Personeli akademik, i përbërë nga profesionistë me eksperiencë dhe kualifikime të larta, mbështet diskutimet, punën në grup dhe orienton studentët në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve komplekse. Gjithashtu, përmes trajnimeve dhe përfshirjes në programe si Erasmus, UL synon përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, duke krijuar një klimë të favorshme për ide inovative dhe studime kërkimore.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.				
Konkluzione	<i>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Përsa i përket standartit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve




Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e diplomimit dhe udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, studenti i programit të ciklit të parë Bachelor në “Financë-Bankë” ka të drejtë të diplomohet përmes provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, bazuar gjithashtu në praguin e notës mesatare. Të gjitha procedurat specifike për mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët. <i>Evidenca 31 Rregullore e Diplomimit 2023-2024</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 78 - Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Në zbatim të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së diplomimit, strukturat përgjegjëse, si Departamenti, Sekretaria Mësimore dhe të gjithë pedagogët udhëheqës, janë të detyruar të asistojnë studentët gjatë procesit të mbrojtjes së diplomës. <i>Evidenca 83. Procesverbal informues mbi provimin e përgjithshëm përfundimtar</i> <i>Evidenca 82. Udhëzues për punimin e diplomës të miratuar me VSA nr7.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në evidencën 31 të rregullores së diplomimit si dhe evidencën 84 për krijimin e komisionit të vlerësimit përfundimtar, konstatohet se procesi mbështetet në testimin e njohurive të përvetësuara gjatë të gjitha viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet sipas rëndësisë dhe peshës specifike të secilës. <i>Evidenca 31 Rregullore e Diplomimit 2023-2024</i> <i>Evidenca 84. Ngritja e Komisionit për vlerësimin e përgjithshëm përfundimtar</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.	Sipas rregulloreve të Fakultetit të Ekonomisë dhe të diplomimit, është përcaktuar që Departamenti i Financë-Bankës përgatit një listë temash diplome në përputhje me fushat përkatëse të studimit. Personeli akademik i departamentit ka përgjegjësinë të udhëheqë dhe mbështetë studentët në orientimin për zgjedhjen e temave dhe fushave të duhura. Fusha e studimit, formulimi i problemit kërkimor dhe i temës mund të zgjidhen nga vetë studenti ose në bashkëpunim me udhëheqësin përkatës. Në vitin akademik 2023-2024, për shkak të mungesës së kërkesave nga studentët për tema diplome, ata iu nënshtruan provimit përfundimtar, siç përcaktohet në rregulloren për diplomim. Studenti përgatitet

Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	për provimin përfundimtar në bazë të listës ku ata pajisen me pyetjet. Universiteti Luarasi ofron të gjitha materialet e nevojshme për zhvillimin e temës së diplomës. Pas mbrojtjes së diplomës, komisioni i caktuar përcakton notën finale. Në përputhje me rregulloren e Universitetit Luarasi, të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Departamentit të Financë-Bankës, diploma mbrohet para një komisioni të posaçëm. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, kryetari i komisionit, në praninë e anëtarëve të tjerë, i komunikon grupit të studentëve vlerësimet përkatëse. Nota përfundimtare llogaritet si mesatarja e notave të secilit anëtar të komisionit.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<i>Evidenca 31 Rregullore e Diplomimit 2023-2024</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 78 - Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në bazë të formatit të diplomës për programin e ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë", si dhe rregulloreve të Universitetit Luarasi, Fakultetit të Ekonomisë, Departamentit të Financë-Bankës dhe programit të studimit, është përcaktuar se, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën Bachelor në "Financë-Bankë". Sipas RVB-së, përbërësit dhe forma e diplomës përcaktohen sipas standardeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Studentit i ofrohet gjithashtu një kopje zyrtare e plotë e programit të studimeve të përfunduar. <i>Evidenca 86. Format diplome dhe suplementi</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB-së, rregullores së sekretarisë mësimore, si dhe gjatë vizitës në Universitetin Luarasi, u konstatua se institucioni ruan dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kur kërkohet, ofron informacion përkatës për secilin student. <i>Evidenca 88.Rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UL përmbush standardet e cilësisë në mësimdhënie, duke ofruar një kuadër rregullator të qartë dhe një staf akademik të kualifikuar. Vlerësimi i dijeve realizohet në mënyrë të drejtë dhe transparente, ndërsa trajnimet për pedagogët dhe struktura për përmirësimin e cilësisë janë të mirëorganizuar.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																								
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Departamenti i Financë-Bankë është njësi kryesore përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi dhe personeli akademik i përfshirë përbëhet kryesisht nga stafi i këtij departamenti. Në varësi të fokusit të lëndëve specifike, për mësimdhënie përfshihet gjithashtu personel akademik nga departamente të tjera të Fakultetit Ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se, që prej vitit akademik 2020-2021, ky program i ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë" nuk është mbuluar në mënyrë të qëndrueshme nga një staf akademik i organizuar sipas edhe të dhënave nga tabela përmbledhëse nr.7 midis PAE dhe PAK. Të dhënat mbi stafin e përfshirë në mësimdhënie për këtë program gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:																																																								
	<table><tr><th>Kualifikimi i stafit akademik</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th></th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>0</td><td>6</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>4</td><td>4</td><td>3</td><td>4</td><td>3</td><td>4</td></tr><tr><td>Dr/Phd në proces</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>2</td><td>0</td></tr><tr><td>MSc.</td><td>2</td><td>7</td><td>3</td><td>4</td><td>2</td><td>4</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>14</td><td>7</td><td>11</td><td>8</td><td>14</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit akademik	2021-2022		2022-2023		2023-2024			PAE	PAK	PAK	PAE	PAE	PAK	Prof. Dr	0	1	0	1	0	0	Prof. Asoc.	1	2	1	2	0	6	Dr/Phd	4	4	3	4	3	4	Dr/Phd në proces	0	0	0	0	2	0	MSc.	2	7	3	4	2	4	Gjithsej	7	14	7	11	8	14
Kualifikimi i stafit akademik	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																				
	PAE	PAK	PAK	PAE	PAE	PAK																																																			
Prof. Dr	0	1	0	1	0	0																																																			
Prof. Asoc.	1	2	1	2	0	6																																																			
Dr/Phd	4	4	3	4	3	4																																																			
Dr/Phd në proces	0	0	0	0	2	0																																																			
MSc.	2	7	3	4	2	4																																																			
Gjithsej	7	14	7	11	8	14																																																			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	Në vitin akademik aktual 2023-2024 (pas konfirmimeve të bëra gjatë vizitës në institucion), në program janë të angazhuar 7 (shtatë) PAE, ku 3 (tre) prej tyre kanë gradën shkencore "Doktor", 2 (dy) janë në proces doktorature dhe 2 (dy) kanë titullin "Master Shkencor". Numri i PAK për këtë vit është 14 (katërmëdhjetë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) mbajnë titullin akademik "Prof. Asoc.", 4 (katër) kanë gradën "Doktor", dhe 4 (katër) kanë "Master Shkencor". Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, konstatohet se plotësohen kërkesat ligjore për kualifikimin e stafit në fushën e programit të studimit. <i>Evidenca nr 144. Tabela nr 6 me të dhënat përmbledhëse Evidencë nr.34 CV e stafit akademik 2020-2021; 2021-2022;2022-2023</i>																				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga verifikimi i të dhënave statistikore të RVB rezulton se në vitin akademik aktual, PAE mbulon 70% të ngarkesës mësimore të programit, ndërsa 30% mbulohet nga PAK. <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>1710</td><td>1080</td><td>630</td><td>63.2% / 36.8%</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1785</td><td>1260</td><td>525</td><td>70.6% / 29.4%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>1800</td><td>1260</td><td>540</td><td>70% / 30%</td></tr></table> <i>Bazuar në këtë analizë, për vitin akademik 2021-2022, rekomandohet që institucioni të rrisë raportin e numrit të PAE ose të ulë ngarkesën mësimore që mbulohet nga PAK, në mënyrë që të përmbushet kërkesa rregullatore për mbulimin e të paktën 70% të ngarkesës mësimore nga stafi akademik PAE.</i> <i>Evidenca nr 144. Tabela nr 12 me të dhënat përmbledhëse</i>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	1710	1080	630	63.2% / 36.8%	2022-2023	1785	1260	525	70.6% / 29.4%	2023-2024	1800	1260	540	70% / 30%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2021-2022	1710	1080	630	63.2% / 36.8%																	
2022-2023	1785	1260	525	70.6% / 29.4%																	
2023-2024	1800	1260	540	70% / 30%																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe	Sipas të dhënave të RVB-së së institucionit dhe dokumentacionit të aplikimit për akreditimin e programit, <i>vihet re se gjatë viteve të fundit ka munguar qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në këtë program.</i> Nga verifikimet e kryera nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, u konstatua se PAE dhe PAK janë të punësuar në bazë të kontratave të punës, të cilat përfshijnë detyrimet e ndërsjella për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.																				

mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Evidenca 90. Modeli Kontratës së punës "Personel Akademik" PAE</i> <i>Evidenca 91. Modeli i Kontratës së punës Personel Akademik PAK</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit për stafin akademik dhe ndihmës në Universitetin Luarasi bazohet në rregulloren e universitetit dhe udhëzimet specifike në nivel institucional dhe në njësitë kryesore. Këto procedura janë përfshirë në Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore, ku përshkruhen hapat për rekrutimin e personelit akademik. Stafi akademik për programin e ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë" është përzgjedhur sipas procedurave të parashikuara në kuadrin rregullator të lartpërmendur dhe në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë në RSH. Departamenti përgjegjës identifikon nevojat për staf akademik bazuar në ngarkesën mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, përgatit kriteret e rekrutimit dhe pasi miratohen nga Fakulteti, ato publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe në mediat audiovizive dhe të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një komision, i cili përbëhet nga përfaqësues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe nga titullari i lëndës përkatëse. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek çdo hap të procesit të rekrutimit dhe të monitorimit të progresit të stafit, duke siguruar transparencë dhe përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. Në dy dosje të përzgjedhura rastësisht gjatë vizitës në institucion u konstatua se dokumentacioni përkatës përfshin: kontratën e punës, diplomat dhe listat e notave të noterizuara për studimet universitare, masterin dhe doktoratën, CV-në, si dhe të dhëna mbi kualifikimet dhe pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore dhe akademike brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e brendshme e Universitetit Luarasi nr. 16 02 2019</i> <i>Evidenca 93. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, e miratuar me VSA nr.3, datë 25.01.2024.</i> <i>Evidenca 95. Procedura e rekrutimit PAE&PAK 2018-2019 deri 2023-2024</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të	Departamenti i Financë-Bankë, përgjegjës për këtë program studimi, ka në strukturën e tij edhe punonjës ndihmës akademikë të angazhuar për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. Po ashtu, në laboratorë dhe mjedise të tjera të disponueshme për studentët, janë të angazhuar edhe personel

mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	ndihmës akademik, i cili kontribuon në zhvillimin efikas të procesit mësimor, në varësi të nevojave të tij. Këtë e konfirmoi gjithashtu GVJ gjatë vizitës në institucion. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Evidenca nr 144. Tabela nr 7 me te dhënat përmbledhëse</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për aplikim dhe nga verifikimi i kryer nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se ekziston një praktikë e plotë për përditësimin e të dhënave për personelin akademik të angazhuar në këtë program. Në dosjet e shqyrtuara rastësisht nga GVJ, vërehet se informacioni mbi stafin akademik dhe atë ndihmës përditësohet çdo vit, duke u organizuar në forma standardizuara të dosjeve personale në përputhje me rregulloren përkatëse. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Evidenca 98.Dosja e punonjësit ne UL- Detyrim i punëmarrësit Departamenti i Burimeve Njerëzore</i> <i>Evidenca 93.Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, e miratuar me VSA nr.3, datë 25.01.2024.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	Universiteti Luarasi ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me përfaqësues biznesi dhe kompani, të cilat ndihmojnë në realizimin e praktikës profesionale për studentët. Stafi akademik që mbulon këtë program është aktiv në monitorimin e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Implementimi i praktikës profesionale, si një komponent i rëndësishëm i programit të studimit, mbështetet në udhëzuesin përkatës të hartuar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin dhe studentët e programit, GVJ vërejti se përgjegjësi i departamentit përcakton edhe koordinatoren përgjegjës për procesin e kryerjes së praktikës profesionale. <i>Evidenca 21: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i>

natyrës së programit të studimit.	<i>Evidenca 29: Udhëzues për zhvillimin e praktikës, shembull, plotësimi i praktikës dhe procesverbalin e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Evidenca 99: Vendimi i përgjegjësit të departamentit për caktimin e koordinatorit të praktikave profesionale.</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Gjatë takimeve me stafin e programit të ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë" dhe studentët, u vu re roli i pedagogëve në monitorimin e praktikës profesionale, si dhe në asistencën e ofruar për hartimin e raportit që studenti dorëzon pas përfundimit të këtij procesi. <i>Evidenca 30 Udhëzues për zhvillimin e praktikës miratuar me VSA nr8, datë 25.01.2024</i> <i>Evidenca 100 - Pasqyre për praktiken mësimore</i> <i>Evidenca 101 - Shembull-Ditari i praktikës profesionale</i> <i>Evidenca 102- Formular vlerësimi nga institucioni pritës</i>			
Konkluzione	<i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik në UL i përmbush kërkesat ligjore për kualifikimet dhe rekrutimet sipas rregullores dhe udhëzimeve institucionale. Departamenti i Financë-Bankë ka staf ndihmës për të mbështetur procesin mësimor, ndërsa universiteti ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me biznese për të siguruar praktika profesionale për studentët. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, GVJ konstaton se numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program nuk ka qenë i qëndrueshëm. Institucioni duhet të bëjë përpjekje për të rritur numrin e PAE dhe për të siguruar që mbi 70% e ngarkesës mësimore të realizohet nga ky personel.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për	Duke iu referuar dokumentacionit të aplikimit dhe vizitës në institucion për infrastrukturën e Universitetit Luarasi, veçanërisht në njësinë kryesore Fakultetin e Ekonomisë dhe Departamentin e Financë-Bankë, GVJ konstaton se




zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare të përshtatshme për realizimin e suksesshëm të programit. Gjithashtu, ka ambiente mbështetëse dhe hapësira për stafin akademik dhe ndihmës, që shërbejnë për studentët. Ambientet mbështetëse, si ato për Burimet Njerëzore, Financa dhe Biblioteka, janë të akomoduar në një godinë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin normal të aktiviteteve të tyre. <i>Evidenca 103. Infrastruktura e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidenca 104. Guida Infrastrukturore-Kapaciteteve pritëse për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 62 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024</i> <i>Konstatime të GJVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitave në institucion, u vërejt se ambientet janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e programit të studimit “Bachelor” në “Financë- Bankë”. Këto ambiente përfshijnë salla leksionesh, zyra dhe laboratore. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Bankës disponojnë hapësira të nevojshme për të garantuar një realizim të suksesshëm të programit. Fakulteti i Ekonomisë ofron ambiente që plotësojnë të gjitha kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, siç është përcaktuar në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohet një sipërfaqe prej 2.5 m² për student, ndërsa institucioni ka një tregues prej 4.575 m² për student. Në këto ambiente është instaluar shërbimi Office 365, që mundëson përdorimin e aplikacioneve Microsoft Office. Godina ofron akses është plotësisht e mbuluar me Wi-Fi. Institucioni gjithashtu ofron një sistem online për vlerësimin e pedagogëve në fund të çdo semestri dhe një platformë e-learning, ku studentët mund të kenë akses në materialet mësimore, njoftimet e pedagogëve dhe komunikime të tjera. UL zotëron një sistem automatik për ruajtjen e të dhënave të studentëve, që shërben si një bazë e rëndësishme të dhënash. Gjithashtu UL së fundmi ka implementuar edhe platformën “Pitagora” nga RASH. <i>Evidenca nr 32. Urdhër dhe Udhëzues për përdorimin e Platformës se Pitagores nga pedagoget</i> <i>Evidenca 44 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-MoodleTeams tutorial</i> <i>Konstatime të GJVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>



Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për mbështetje të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkencore, institucioni disponon tri laboratorë të informatikës, të cilët janë të pajisur me programe moderne dhe janë në shërbim të studentëve dhe stafit. Këta laboratorë përdoren gjithashtu për përgatitjen e seminareve, detyrave të kursit dhe të temave të diplomave. <i>Evidenca 103. Infrastruktura e Universitetit Luarasi</i> <i>Evidenca 62 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorëve janë moderne dhe përfshijnë, përveç aplikacioneve bazë, edhe software të specializuar që lidhen me lëndët e këtij programi, siç është Ekonometria, e cila shfrytëzon modelime të ndryshme. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e siguruar nga institucioni dhe vizitën e kryer, arrin në përfundimin se mjediset mësimore dhe infrastruktura të cilat mbështesin zhvillimin e programit janë të përshtatshme për një funksionim normal të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni dhe në vizitën e GVJ në ambientet e bibliotekës së UL, evidentojmë se për modulet dhe lëndët e programit, studentëve i'u ofrohen literaturë bazë dhe ndihmëse, e cila është e përcaktuar në syllabuset përkatëse, si në format fizike ashtu edhe digjitale. Megjithatë, mendojmë se numri i titujve të librave në shqip dhe në gjuhë të huaj të lidhur me këtë program duhet të rritet, përfshirë titujt e viteve të fundit, me qëllim që të pasurohet më tej fondi i bibliotekës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranç gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

parashikuara në programin e studimit.	<i>Evidenca 106-Lista e librave në bibliotekë</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni dhe në vizitën e GVJ pranë bibliotekës, konstatohet se për disa module të këtij programi mungon literatura në shqip. Gjithashtu mungonin edhe cikle leksionesh të shkruara nga titullari <i>referoju edhe Standardit III .1 kriteri 2 si më sipër detajuar.</i> Sipas edhe evidencave dhe nga vizita në UL, u vërejt se është bërë kërkesë për të pasuruar fondin e bibliotekës me disa tekste bashkëkohore që përdoren në këtë program. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca 108. Propozim i literaturave shtesë në bibliotekë</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit dhe vizitën në Fakultetin Ekonomik të UL, u vërejt se studentët e programit kanë akses në Bibliotekën Mësimore, e cila ndodhet në godinën ku zhvillohet mësimi. Në ambientet e kësaj biblioteke, studentët kanë mundësi të barabarta për të shfrytëzuar shërbimet, për të studiuar dhe për të aksesuar literaturën e ofruar. Orari dhe shërbimi janë të adaptuara për të përmbushur nevojat e studentëve, duke qenë se mjediset e bibliotekës janë të hapura nga e hëna deri në të premte me orar 08:30-20:00. Megjithatë, mendojmë se ambientet për studim duhet të jenë më të bollshme për studentët. Biblioteka ofron gjithashtu mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion, u vërejt se biblioteka është <i>relativisht</i> e pajisur me literaturë fizike në shqip, e cila përfshin tekste mësimore, libra, revista periodike, buletine të institucioneve përsa i përket programit të studimit në ciklin e parë “Bachelor” në “Financë -Bankë”. Shërbimi në bibliotekë ofrohet nga punonjës të caktuar. <i>Siç është theksuar më parë, është e nevojshme që ky fond literature të pasurohet më tej me literatura bashkëkohore.</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL)</i>

Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shërbimet aktuale të bibliotekës ofrojnë akses të barabartë për të gjithë përdoruesit potencialë, përfshirë studentët dhe stafin akademik, pa kosto, pasi ata mund të anëtarësohen. Përveç kësaj, biblioteka ofron shërbimin online përmes një platforme digjitale të menaxhimit të librave, e cila u mundëson përdoruesve të aksesojnë baza të dhënash dhe informacion të dobishëm në fushën e ekonomisë, për t'i analizuar dhe përdorur në punimet e tyre kërkimore shkencore. UL është pjesë e U-Library ku studentët kanë mundësi ta aksesojnë jo vetëm nga salla e bibliotekës por edhe online. <i>Evidenca 64 Manual Përdoruesi Sistemi i Menaxhimit online te Bibliotekës së UL</i> <i>Evidenca 110: https://ulibrary.rash.al/</i> <i>Evidenca 111- Formulari i aplikimit dhe marrëveshja për anëtarësimin online.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ka në dispozicion një program kompjuterik për gjetjen e titujve të librave. Megjithatë, në ambientet e bibliotekës nuk u gjetën pajisjet kompjuterike që studentët mund të përdorin. Fondi i bibliotekës është informatizuar, duke e bërë më të lehtë gjetjen e literaturës përkatëse. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka operon nga ora 08:30 deri në 20:00, duke ofruar shërbime për studentët e të gjitha programeve. Gjatë sezonit të provimeve, sipas edhe të RVB-së, kjo bibliotekë ofron orar të zgjatur në përputhje me nevojat e studentëve dhe kapaciteteve të tyre. <i>Raporti i vlerësimit të Brendshëm (RVB)</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga	GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitën në UL, vëren një komunikim institucional në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Në lidhje me evidentimin tonë për mungesat në literaturën bashkëkohore të programit, drejtuesi i Departamentit të Financë Bankë bazuar edhe në evidencat, kishte bërë kërkesën e për të pasuruar këtë fond, si për materialet fizike ashtu edhe për ato online.




personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FE të UL) Evidenca 108. Propozim i literaturave shtesë në bibliotekë			
Konkluzione	GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, arrin në përfundimin se institucioni disponon ambiente të veçanta për studim dhe një bibliotekë me një fond literaturë relativisht të pasur që mbështet procesin e mësimdhënies për stafin dhe studentët. Staf i akademik dhe studentët kanë akses në bibliotekën dixhitale përmes disa platformave online, për të cilat institucioni ka lidhur kontrata shërbimi. Bazuar në syllabuset e lëndëve të programit, institucioni duhet të pasurojë më tej fondin e bibliotekës me literaturë më të fundit, përfshirë edhe materiale në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Administrimi i informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetet e tyre realizohet nga njësitë kryesore të UL, përmes sekretarisë mësimore, zyrës së rekrutimit dhe pranimi, si dhe zyrës së karrierës. Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, institucioni përdor sistemin Luarasi Moodle-LSM, gjithashtu ishte vënë në funksion këtë vit akademik sistemi i "Pitagorës". Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Ekonomisë, ku evidentoi administrimin e informacionit për studentët, duke filluar nga faza e regjistrimit dhe deri në procesin e diplomimit. <i>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, grupi i GVJ evidentoi sa vijon:</i>

	• Në regjistrin themeltar u identifikua një korrëgjim për 13 studentë të vitit 2019, me procesverbal të mbajtur në vitin 2021. • U konstatuan dy raste me korrëgjime të numrit të matrikulimit, për të cilat nuk ishte mbajtur procesverbal. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca 33 .Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga studenti</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit për personelin akademik dhe ndihmës realizohet përmes platformës "SharePoint," e cila ofron të dhëna për oraret e mësimi, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit dhe informacione të tjera sipas hierarkisë përkatëse. Personeli dhe studentët mund të kenë akses në informacionin e administruar nga Sekretaria mësimore pas një kërkesë të paraqitur prej tyre. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi Luarasi Moodle (LMS) përditësohet me të gjithë informacionin që mbulon procesin e regjistrimit, zhvillimin e programit dhe diplomimin e studentëve, duke mundësuar bashkërendimin e informacionit mes pedagogëve dhe studentëve. Ky sistem përfshin përmbajtjen e programit, procesin e mësimdhënies, materialet didaktike të ofruara nga pedagogët, detyrat e kursit, si dhe vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-MoodleTeams tutoriale</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni siguron informacionin e nevojshëm jo vetëm përmes platformës së studentëve "Luarasi Moodle-LSM," por edhe përmes kanaleve të tjera elektronike dhe rrjeteve sociale të njohura në tregun e informacionit, të cilat plotësojnë infrastrukturën për komunikim dhe ndarjen e informacionit. Këto sisteme ofrojnë mundësi për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët. Ndërkohë, e-mail-i vazhdon të mbetet një nga format kryesore të komunikimit. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-MoodleTeams tutoriale</i>




Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, që përfshin të gjitha platformat dhe mjetet e përmendura, mundëson monitorimin dhe shpërndarjen në kohë reale të informacionit mbi veprimtaritë administrative dhe akademike të institucionit. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-MoodleTeams tutoriale</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sipas konstatimeve të GVJ-së, faqja e internetit e UL përmban informacion mbi programin e studimit, stafin, si dhe njoftime lidhur me datat e provimeve, oraret e studimeve dhe mundësitë e punësimit. Institucioni përditëson rregullisht faqen e tij të internetit dhe platformat e rrjeteve sociale për të siguruar komunikim të vazhdueshëm me publikun. https://luarasi-univ.edu.al/ https://luarasi-univ.edu.al/economy-faculty/			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe në vizitën e realizuar në ambientet e tij, konkludon se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit për administrimin dhe monitorimin e veprimtarisë akademike përmbush standardet në mbështetje të procesit mësimor, stafit akademik dhe studentëve të programit.</i> <i>Në sekretarinë mësimore u vunë re parregullsi në mbajtjen e procesverbaleve për disa korrigjime në regjistrin themeltar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për	Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihen Relacioni për Planifikimin e Buxhetit Vjetor për periudhën 2022-2023, Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditit të Pavarur. Dokumentacioni tregon se 98% e burimeve financiare të institucionit përbëhen kryesisht nga tarifat e studimeve, ndërsa pjesa e mbetur përfshin donacione dhe të ardhura nga aktivitete të tjera. Rritja e shpenzimeve është shpjeguar si e nevojshme për rekrutimin e stafit të ri për Fakultetin e Mjekësisë dhe për sigurimin materialeve didaktike.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumentacionit, institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare, duke operuar me fitim dhe duke garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të programeve nga këndvështrimi financiar. <i>Evidenca 113. Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor</i> <i>Evidenca 116. Pasqyrat Financiare 2021-2023</i> <i>Evidenca 115. Raport Auditit 2022-2023</i>																
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton relacionin për planifikimin e buxhetit vjetor bazë të përmendur edhe në kriterin 1 të standardit IV.5, i cili miratohet nga senati dhe bordi i administrimit. Si një tërësi, dokumentacioni financiar pasqyron qëndrueshmërinë financiare në zbatimin e programeve të studimit. Ky dokumentacion nuk përpilohet në nivelin e njësisë bazë (departamentit) që mbulon programin përkatës. Të dhënat mbi tarifat, kostot për student, të ardhurat etj., janë të përmbledhura në nivel institucional për të gjithë studentët e UL, (janë 1529 studentë gjithsej për vitin akademik 2022-2023 dhe 1538 për vitin akademik 2023-2024) dhe nuk janë të dhënat të specifikura në nivel departamenti. <i>Sa i përket programit të ciklit të parë Bachelor në “Financë-Bankë”, nga raporti për planifikimin e buxhetit vjetor vërehet një rënie në numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar, sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën më poshtë (marrë nga raporti vjetor për planifikimin e buxhetit).</i> <table><tr><th></th><th><i>Të rregjistruar 2021-2022</i></th><th><i>Të Diplomuar 2021-2022</i></th><th><i>Të rregjistruar 2022-2023</i></th><th><i>Të diplomuar 2022-2023</i></th></tr><tr><td>I</td><td>25</td><td rowspan="3">46</td><td>18</td><td rowspan="3">33</td></tr><tr><td>II</td><td>34</td><td>25</td></tr><tr><td>II</td><td>45</td><td>34</td></tr></table> <i>Duke pasur parasysh prirjen në rënie të numrit të studentëve, është e domosdoshme që institucioni të hartojë dokumentacionin financiar edhe në nivelin e njësive bazë. Kjo do të sigurojë një pasqyrë më të saktë dhe të detajuar mbi qëndrueshmërinë financiare të secilit program studimi</i> <i>Evidenca 114. Praktika për miratimin e buxhetit 2023-2024, e plotë bashkë me vendimin e bordit</i> <i>Evidenca 113. Relacion për Planifikimin e Buxhetit Vjetor</i> <i>Evidenca 116. Pasqyrat Financiare 2021-2023</i> <i>Evidenca 115. Raport Auditit 2022-2023</i> <i>Evidenca nr.17 Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023 Universiteti Luarasi</i>		<i>Të rregjistruar 2021-2022</i>	<i>Të Diplomuar 2021-2022</i>	<i>Të rregjistruar 2022-2023</i>	<i>Të diplomuar 2022-2023</i>	I	25	46	18	33	II	34	25	II	45	34
	<i>Të rregjistruar 2021-2022</i>	<i>Të Diplomuar 2021-2022</i>	<i>Të rregjistruar 2022-2023</i>	<i>Të diplomuar 2022-2023</i>													
I	25	46	18	33													
II	34		25														
II	45		34														




Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UL, si pjesë e "Hysenbelliu Grup", kryen auditime të brendshme në kuadër të këtij grupi. Ndërkohë, në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, përfshihet edhe Raporti i Auditorit të Pavarur për Shoqërinë "Universiteti Luarasi" Sh.p.k, si pjesë e detyrimeve procedurale. <i>Evidenca 115. Raport Auditit 2022-2023</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ nuk evidentoi raportim të realizimit të buxhetit deri në nivelin e njësisë bazë lidhur me aspekte financiare për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë- Bankë"(sqaruar edhe në kriterin 2 të standartit IV.5).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Sipas dokumentacionit financiar të UL, institucioni ka treguar një qëndrueshmëri financiare gjatë tre viteve të fundit. Megjithatë janë rritur shpenzimet, kjo është justifikuar nga hapja e fakultetit të mjekësisë, ndërkohë që janë rritur edhe burimet e të ardhurave dhe rezultati financiar. Nga ana tjetër, vazhdimi i prirjes në rënie të numrit të studentëve mund të paraqesë një risk për qëndrueshmërinë financiare të programit në të ardhmen. Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe për të gjeneruar fitim. <i>Evidenca 116. Pasqyrat Financiare 2021-2023</i> <i>Evidenca 114. Praktika për miratimin e buxhetit 2023-2024, e plotë bashkë me vendimin e bordit</i>			
Konkluzione	GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar në UL, konkludon se institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare, duke siguruar fonde dhe mbështetje të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor e kërkimor dhe, rrjedhimisht, për funksionimin e suksesshëm të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standartit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika dhe procedura të qarta për procesin e regjistrimit të studentëve, realizimin e programeve të studimit dhe diplomimin e tyre. Për këtë qëllim, janë miratuar një sërë aktesh rregullative. Në statutin e UL, në Kreun V, nenet 55, 56, 65, 66, dhe 67, janë të përcaktuara qartë të gjitha procedurat që lidhen me programet e studimit të ciklit të parë, shpalljen e kriterëve, dokumentacionin, rastet e transferimit të studimeve, etj. Në zbatim të statutit të UL-së, janë hartuar edhe katër rregullore specifike: 1. Rregullorja e Universitetit; 2. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë; 3. Rregullorja e Departamentit të Financë-Bankë; 4. Rregullorja e programit të studimit. Këto akte nënligjore dhe rregullative përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat që përcjellin ecurinë e studentit nga regjistrimi deri në përfundim të programit. <i>Evidenca 1. Statutit i Universitetit "Luarasi" nr. 502-2023</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	GVJ konstaton, nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e zbatuara gjatë gjithë ciklit të studimeve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat mbështesin studentët në çdo hap të përparimit të




studentë dhe studentët e programit të studimit.	tyre përgjatë programit të ciklit të parë të studimeve në "Financë-Bankë. <i>Evidenca 2.Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca11.Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në përputhje me kuadrin rregullator të përmendur më sipër, GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për regjistrim në këtë program janë të përcaktuara qartë. Institucioni përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat bazuar në kapacitetet pritëse të UL. Sipas rregullores së UL, Departamenti i Financë-Bankës, i cili mbulon këtë program, propozon kriteret e pranimit, të cilat miratohen nga Dekani dhe më pas nga Senati Akademik. Në periudhën e përcaktuar nga MAS, UL organizon takime informuese me maturantët përmes grupeve të pedagogëve dhe stafit administrativ. <i>Evidenca 2.Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca11.Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 117. Urdher per ngritjen e grupit te punes per takime me maturantet</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedura e pranimit për studentët e ciklit të parë në programin "Financë-Bankë" është e qartë dhe transparente. Studentët janë të detyruar të njohin këto kriteret, të cilat janë të thjeshta, të kuptueshme dhe të lehta për t'u ndjekur nga kushdo i interesuar. Po ashtu, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe transferimit janë të qarta dhe të kuptueshme. Të gjitha këto informacione janë bërë publike dhe janë të aksesueshme në faqen e internetit të universitetit. <i>Evidenca 2.Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i>




	<i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 118. Udherrefyesi i studimit 2022-2023.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti dhe fakulteti kanë politika të përgjithshme për rekrutimin, si dhe politika specifike për pranimin e studentëve për çdo program studimi dhe çdo vit akademik. Këto politika, të përcaktuara në statutin e UL, mund të pësojnë ndryshime me kalimin e viteve. Kriteret hartohen në fillim të çdo viti akademik dhe informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për studimet dhe pranimin është bërë publik në faqen e internetit të universitetit: www.luarasi-univ.edu.al. <i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 118. Udherrefyesi i studimit 2022-2023.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni përgatit dhe publikon, para fillimit të vitit akademik, kriteret specifike për kandidatët me aftësi të veçanta ose për ata nga grupe të pakicave. www.luarasi-univ.edu.al.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullativ të UL-së, të përmendur më sipër edhe më sipër, nenet dhe kriteret e pranimit përcaktojnë gjithashtu kriteret specifike për kandidatët nga vende të tjera. <i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi"</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 18. Rregullore e Departamentit të Financë Bankës, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit	Gjatë vizitës së GJVJ në institucion, si dhe në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës, u evidentuan raste mbështetjeje financiare për studentët e ciklit të parë Bachelor në rang universiteti. Në programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor




në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	në Financë-Bankë, ishte një studente që kishte fituar një bursë si rezultat i statusit të saj civil si jetim. <i>Evidenca 119. Rregullore për bursat studentore.</i> <i>Evidenca 120. Statistika për bursat 2021-2023 VBA Bursat Studentore 2021-2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe vizitës në UL, konkludon se institucioni ka procedura të plota për pranimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it të UL, si dhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion, vërejmë se studentët e regjistruar në këtë program kanë akses në informacion të plotë lidhur me ecurinë dhe progresin e tyre akademik përmes disa kanaleve komunikimi. Informacionin e përgjithshëm, studentët e marrin përmes faqes së internetit të UL, ku përditësohen njoftimet dhe informacionet më të fundit, përfshirë orarin mësimor, grafikun e provimeve dhe datat e eventeve të tjera. Një informacion më specifik për modulët e programit u ofrohet studentëve në fillim të çdo lënde, përmes seminarit udhëzues që zhvillohet javën e parë të mësimit, ku ata njoftohen me syllabusin e modulit, literaturën e nevojshme dhe format e vlerësimit. Një kanal tjetër komunikimi është përdorimi i adresave elektronike të pedagogëve dhe studentëve, të cilat mund të jenë individuale ose adresa të grupeve mësimore (ky program ka një grup studentësh), ku ata informohen mbi vlerësimet dhe njoftimet për reklamime. <i>Evidencë nr.14 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti dhe fakulteti informojnë rregullisht studentët mbi kriteret për njohjen e nivelit të studimeve të mëparshme, përfshirë llojin e shkollave dhe nivelin e plotë ose të pjesshëm të studimeve. UL pranon transferime studimesh nga degë, fakultete ose universitete të tjera, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, me kushtin që të plotësohen kreditet e parashikuara në ligjin për arsimin e lartë, rregulloren e shkollës dhe statutin e universitetit. <i>Evidenca 11.Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 45 Praktika për transferimin e studimeve, FE</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë, është përfshirë një pjesë e rëndësishme që trajton vlerësimin e njohurive dhe format e vlerësimit të dijes. Procedurat janë përcaktuar qartë, duke përfshirë llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe ato finale për secilën lëndë, si dhe mënyrat e organizimit të provimeve dhe format e hartimit të tezave. Po ashtu, janë përshkruar procedurat e miratimit të tezave nga këndvështrimi administrativ dhe akademik, si dhe elemente të tjera të nevojshme. Format e vlerësimit dhe koha e përmbushjes së detyrimeve për secilën lëndë dhe për të gjithë studentët shpjegohen në orët e para të kontaktit midis pedagogut dhe studentëve në auditor, dhe kjo është parashikuar gjithashtu në syllabusat e lëndëve. <i>Evidenca 11.Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidencë nr.14 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përveç kuadrit rregullator të përmendur më sipër, i cili përfshin përcaktime për provimin përfundimtar të përgjithshëm dhe procedurat për përgatitjen e diplomës, një rol të rëndësishëm luan edhe informimi i studentëve. Nga takimi me studentët e këtij programi, u konfirmua se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës, si dhe për provimin përfundimtar të përgjithshëm, në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë. <i>Evidenca 11.Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca 82.Udhezues per punimin e diplomes te miratuar me VSA nr.7 date 25/01/24, shembull teme diplome dhe formular aplikimi per temen e diplome</i>




Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përveç takimeve që stafi akademik zhvillon me shkollat e mesme gjatë procesit të ofertës akademike, studentët marrin informacion të plotë që në fazën e aplikimit dhe më tej, përmes takimeve pranë zyrës së informacionit, sekretarisë mësimore, udhëzuesve të studentëve, faqes së internetit të institucionit, dhe burimeve të tjera. Nga takimi me stafin akademik, u evidentua gjithashtu roli i Departamentit të Financë-Bankës në informimin e kandidatëve potencialë për regjistrim në këtë program, duke përfshirë studentët në përfundim të programit Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë. <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion.</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, e miratuar me VSA nr.12024</i> <i>Evidenca11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Financë Bankë.</i> <i>Evidenca118. Udhërrefyesi i studimit 2022-2023</i> <i>Evidenca 88. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UL disponon dokumentacion të plotë për informimin e studentëve mbi kriteret e pranimit, detyrimet e tyre në lidhje me programin e studimit, rregullat dhe afatet e përmbushjes së detyrimeve, mbrojtjen e provimit përfundimtar, si dhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni si para ashtu edhe gjatë periudhës së regjistrimeve, ofron informacion të rëndësishëm për studentët kandidatë dhe ata që regjistrohen, duke i njohur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Në UL zhvillohet edhe java e orjentimit për studentët e regjistruar rishtaz. Nga vizitat në mjediset e UL, takimet dhe kontaktet me studentët, si dhe nga dokumentacioni mbështetës i RVB-së, konkludohet se studentët janë të informuar dhe me detaje mbi strukturën e programit të studimeve, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij,

	përfshirë limitet dhe hapësirat e lejuara. Për realizimin e këtij objektivi janë përdorur forma të ndryshme informimi, si java e orientimit dhe mirëseardhjes, vizitat gjatë ditëve të regjistrimit, takimet informuese dhe sqaruese, të cilat i mbështesin studentët në marrjen e vendimit përfundimtar për regjistrim. <i>Evidenca 75. Java e orientimit per studentet e rinj</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në Rregulloren e programit të ciklit të parë në Bachelor në Financë-Banke, përveç informacioneve të tjera të dobishme, është paraqitur edhe programi mësimor, i ndarë sipas lëndëve/moduleve, me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë tij. Gjithashtu, studentët njihen me përmbajtjen e programit për secilën lëndë që në fillim të procesit mësimor. <i>Evidenca 11. Rregullore e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Financë Bankë.</i> <i>Evidencë nr. 14 Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë</i> <i>Evidenca 118. Udhërrefyesi i studimit 2022-2023</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët janë të mirëinformuar për mundësitë e punësimit që në fillim dhe gjatë gjithë kohës së studimeve. Nga takimi me ta, u evidentua se studentët janë në dijeni për marrëdhëniet e bashkëpunimit që institucioni ka me aktorë të biznesit në vend. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si dhe Zyra Alumni, duke ofruar informacion të vlefshëm për mundësitë e tyre të punësimit në të ardhmen. <i>Evidenca 122. Rregullore e zyres se studentit 2023-2024</i> <i>Evidenca 123. Rregullore e zyres se keshillimit te karrieres 2023-2024</i> <i>Evidenca 21. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Takimi me studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë akses të plotë për marrjen e informacionit, si përmes të gjitha kanaleve të komunikimit elektronik të përmendura më sipër, ashtu edhe nëpërmjet kontakteve direkte me stafin akademik të programit, drejtuesit e njësive kryesore, Zyrën e Karrierës dhe sekretarinë mësimore. <i>Evidenca 122. Rregullore e zyres se studentit 2023-2024</i> <i>Evidenca 125. Urdher per Kalendarin Akademik</i>




	<i>Evidenca 104 Guida Infrastrukturore-Kapaciteteve pritëse për vit akademik 2023-2024</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i informacionit, me të gjitha format e analizuara më lart, është i aksesueshëm edhe për studentët në distancë. Gjatë takimit me studentët e programit, ata shprehën një vlerësim pozitiv për lehtësinë e marrjes së informacionit. <i>Takimi me studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Luarasi ofron forma dhe metoda të ndryshme për informimin lidhur me organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Studentët e këtij programi kanë akses në informacion përmes kanaleve elektronike dhe janë të integruar në një platformë të posaçme për informim të brendshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4									
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	UL disponon evidenca dhe statistika, të përditësuara çdo vit, që përfshijnë të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik për këtë program studimi. Sipas raportit vjetor, rezulton se nga viti 2021 deri në vitin 2023, numri total i studentëve të diplomuar është : <table><tr><th>Të Diplomuar 2021-2022</th><th>Të diplomuar 2022-2023</th><th>Total</th></tr><tr><td>46</td><td>33</td><td>79</td></tr></table>			Të Diplomuar 2021-2022	Të diplomuar 2022-2023	Total	46	33	79
Të Diplomuar 2021-2022	Të diplomuar 2022-2023	Total							
46	33	79							
	<i>Evidenca nr.17 Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023 Universiteti Luarasi</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre,	Universiteti disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Sipas të dhënave statistikore dhe inspektimeve nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) gjatë periudhës 2021-2024, vërehet një rënie në numrin e regjistrimeve, ku aktualisht në vitin e parë janë regjistruar vetëm 15 studentë. Kjo tendencë është e pranishme edhe në								

tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në program. Sekretaria mësimore ruan dhe përditëson të dhënat e çdo studenti dhe statistikën e përgjithshme për këtë program, në regjistra të veçantë sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit. <table><tr><td>Viti</td><td>Të rregjistruar 2021-2022</td><td>Të rregjistruar 2022-2023</td><td>Të rregjistruar 2023-2024</td></tr><tr><td></td><td>33</td><td>21</td><td>15</td></tr></table> <table><tr><td>Të rregjistruar 2021-2022 (Total)</td><td>Të rregjistruar 2022-2023(Total)</td></tr><tr><td>104</td><td>77</td></tr></table> <i>Evidenca nr. 15 Të dhëna statistikore të studenteve të reregjistruar në Bachelor në "Finance- Banke"</i> <i>Evidenca nr.17 Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023 Universiteti Luarasi</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>	Viti	Të rregjistruar 2021-2022	Të rregjistruar 2022-2023	Të rregjistruar 2023-2024		33	21	15	Të rregjistruar 2021-2022 (Total)	Të rregjistruar 2022-2023(Total)	104	77
Viti	Të rregjistruar 2021-2022	Të rregjistruar 2022-2023	Të rregjistruar 2023-2024										
	33	21	15										
Të rregjistruar 2021-2022 (Total)	Të rregjistruar 2022-2023(Total)												
104	77												
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të universitetit, që përfshin regjistra të printuar dhe dokumente elektronike. Këto të dhëna janë lehtësisht të kontrollueshme dhe të verifikueshme nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ verifikoi regjistrimet e studentëve në regjistrin themeltar. Institucioni përdor sistemin Pitagora, në bazë të marrëveshjes me RASH dhe të dhënat mblidhen nga dokumentet bazë, procesverbalet dhe dokumentet e tjera të përgatitura dhe plotësuara sipas akteve dhe rregulloreve të UL. <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca 41 Urdhër për përdorimin e platformës Pitagora</i> <i>Evidenca 88 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>												
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet	Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga sekretaria mësimore i nënshtrohen kontrolleve periodike nga strukturat e tjera eprore dhe përdoren në analizat akademike të Departamentit të Financës-Bankës si njësi bazë dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore. Këto të dhëna gjithashtu kryqëzohen me informacionin e përpunuar nga sistemet e brendshme të menaxhimit dhe përpunimit të universitetit. <i>Evidenca 41 Urdhër për përdorimin e platformës Pitagora</i> <i>Evidenca 88 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>												




me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës së realizuar nga GVJ në institucion, u evidentua bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Financës-Bankës dhe zyrës Alumni të universitetit për shkëmbimin dhe analizën e të dhënave të studentëve të regjistruar. Në analizën e përgatitur nga departamenti përfshiheshin të dhëna mbi hyrjen dhe daljen e numrit të studentëve, por mungonin informacione mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve në programin Bachelor për Financë-Bankë. <i>Evidenca nr 20. Analiza e Departamentit të Finance- Bankës mbi programin e studimit Bachelor ne Finance -Banke : 2021-2022,2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>UL menaxhon dhe përditëson statistikën e studentëve përmes sistemeve të brendshme, përfshirë Pitagora dhe regjistrat e miratuar nga Ministria e Arsimit. Të dhënat tregojnë një rënie në regjistrimet në programin Bachelor në Financë-Bankë gjatë viteve 2021-2024. Bazuar edhe në kriterin 5 vlen për tu theksuar se bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Financës-Bankës dhe zyrës Alumni ndihmon në analizën e të dhënave, por mbetet nevoja për të plotësuar informacionin mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve i cili mungonte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në përputhje me ligjin 80/2015 dhe statutet dhe rregulloret e tij, UL garanton përfaqësimin e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel institucional, si në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe NJSBC. Sipas rregullores së UL, operon gjithashtu Këshilli Studentor, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse, si dhe angazhimi i tyre në takimet e zhvilluara nga këto struktura përmes vendimeve të miratuara për ngritjen dhe funksionimin e tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<i>Evidenca 1 Statutit i Universitetit "Luarasi" nr. 502-2023</i> <i>Evidenca 2.Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi", nr. 17 2023</i> <i>Evidenca 127. VSA nr.16,2023 Per konstituimin e Senatit akademik te UL</i> <i>Evidenca 128. VSA nr.24, 2023 Per krijimin e NJSBKC te UL</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it dhe nga takimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, u evidentua roli aktiv i studentëve dhe i përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Po ashtu, studentët luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin periodik të nivelit të mësimdhënies, proces që realizohet përmes anketave anonime dhe diskutimeve direkte me titullarët e lëndëve përkatëse të programit. Përveç kësaj, në RVB të programit, një nga anëtarët e grupit është student. <i>Evidenca 130. Rregullorja e këshillit studentor te UL</i> <i>Evidenca 122. Rregullore e zyrës se studentit 2023-2024</i> <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit bëhet kryesisht përmes vlerësimeve të tyre, të cilat mbledhen nëpërmjet anketave për programin dhe për pedagogun e lëndës, të organizuara nga NJSBC. Po ashtu, ky vlerësim përforcohet nga diskutimet që studentët zhvillojnë me pedagogët e lëndëve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit dhe verifikimi gjatë vizitës në institucion, <i>GVJ nuk ka evidentuar ndryshime në kurrikulën e programit të studimit që nga fillimi i tij në vitin 2021.</i> <i>Evidenca 132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik</i> <i>Evidenca 58. Raport mbi Pyetësorët Studentore 2021-2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidenca 130. Rregullorja e këshillit studentor te UL</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit dhe në takimin e GVJ me studentët e programit, u vërejt se studentët kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre për përmirësimin e programit dhe gëzojnë të drejtën e ankimimit lidhur me procesin e vlerësimit. Gjithashtu, nga takimi me stafin akademik që zhvillon këtë program, u konfirmua se studentët kanë mundësi të shprehin ankesat e tyre dhe angazhimin për gjetjen e zgjidhjeve. <i>Takime me studentë gjatë vizitës në institucion të GVJ</i> <i>Evidenca 132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik</i>

njesisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Evidenca 131. Kërkesa nga studentet</i>			
Konkluzione	<i>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të universitetit dhe prania e tyre në këto struktura është e garantuar institucionalisht. Megjithatë, ata rrallëherë shprehin shqetësime apo sugjerime për përmirësimin e programeve. Studentëve u ofrohen të gjitha mundësitë e nevojshme për të rishikuar vlerësimet e tyre në rast se konsiderojnë se rezultatet e arritura nuk përputhen me pritshmëritë e tyre. Pedagogët janë të gatshëm dhe të detyruar të ofrojnë sqarime përmes seancave të posaçme kur është e nevojshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Përveç Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingun, UL ofron informim dhe mbështetje për studentët kryesisht përmes zyrave të dedikuara për pritjen, informimin dhe këshillimin e tyre: Zyra e Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Nga takimet e GVJ-së me anëtarët e këtyre zyrave dhe studentët, u konstatua se këto zyra funksionojnë në shërbim të studentëve, në përputhje me aktet rregullatore të UL-së. <i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi", nr. 17 2023</i> <i>Evidenca 123. Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës 2023-2024</i> <i>Evidenca 122. Rregullore e zyrës së studentit 2023-2024</i> <i>Takimet gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë	Informimi i studentëve për programin e studimit realizohet që nga procesi i regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe deri në përfundimin e diplomimit, kryesisht përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Studentëve dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Studentët mund të marrin informacion mbi ecurinë e vlerësimit të procesit mësimor edhe nga anëtarët e stafit akademik që mbulojnë këtë program dhe nga njësia bazë e institucionit. Në fillim të çdo viti akademik, Fakulteti i

me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ekonomisë, si njësi kryesore e programit, organizon javën e orientimit për studentët, ku ata marrin informacion të detajuar mbi procesin mësimor, platformat e përdorura, mënyrat e vlerësimit, modelin e një programi lënde etj. <i>Evidenca 123. Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës 2023-2024</i> <i>Evidenca 122. Rregullore e zyrës së studentit 2023-2024</i> <i>Evidenca 75. Java e orientimit për studentët e rinj</i> <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjekin të gjithë procesin e informimit për studentët dhe bashkëpunojnë me struktura të tjera të institucionit për të siguruar një informim sa më të plotë. Këto zyra mbajnë gjithashtu lidhje me tregun e punës, duke orientuar studentët për mundësi praktike dhe punësimi. <i>Evidenca 123. Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës 2023-2024</i> <i>Evidenca 122. Rregullore e zyrës së studentit 2023-2024</i> <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron vazhdimisht punësimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve si edhe pas diplomimit. Çdo vit akademik, kjo zyrë harton një raport analitik, duke përditësuar të dhënat mbi punësimin e tyre për çdo nivel programi. <i>Evidenca 52. Raport analitik mbi diplomimin dhe punësimin e studentëve Alumni 2017-2023</i> <i>Takime me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>
Konkluzione	<i>Universiteti "Luarasi" ka zyra të dedikuara që ndjekin progresin dhe ecurinë e programit të studimit Bachelor në "Financë-Bankë". Sekretaria Mësimore, Zyra e Studentëve dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës janë kanalet kryesore për informimin e studentëve, si para, gjatë, ashtu edhe pas diplomimit. Nga këndvështrimi institucional, progresi</i>




	<i>akademik dhe zhvillimi i karrierës së studentëve monitorohet nga këto zyra.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit, RVB dhe në takimin me stafin akademik të programit dhe studentët e tij, GVJ konstatoi se UL ka struktura dhe procedura të mirë përcaktuara për SBC në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. UL ka ngritur NJSBC-në në nivel institucional e cila funksionon në përputhje me rregulloren e NJSBC-së së UL. Institucioni ka hartuar udhëzuesin strategjik të metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu janë organizuar edhe trajnime në nivel institucional për procesin e mësimdhënies ku në të ka pasur edhe anëtarë të stafit të Departamentit të FB. Ndihmë në këtë drejtim është edhe hartimi nga institucioni i Planit Strategjik të Ndërkombëtarizimit. Institucioni ka të plotë kuadrin rregullativ të SBC si atë të Politikave dhe procedurave të UL që kanë fokus të tyre rritjen e cilësisë. <i>Evidencë nr.48.Udhezues i Metodave inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidencë nr.65.Modul trajnimi akademik writing Skills</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBC</i> <i>Evidencë nr.136.Politikat e UL për Sigurimin e brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidencë nr.137.Procedurat e UL për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë:</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	NJSBC është pjesë e strukturës së UL në varësi të Zv. Rektorit për mësimin. Kjo njësi e bazon veprimtarinë e saj në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe gjithashtu: - harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, - vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore duke hartuar raporte të vlerësimit nga studentët të procesit mësimor si dhe të vlerësimit të performancës së personelit akademik; - realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë; - harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë; - prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së UL-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në UL. Njësia bazë vlerëson dhe miraton raportet mbi monitorimin e aftësive të mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik. <i>Evidencë nr.50.Vendim e Senatit Akademik te UL "Për Manualin NJSBC"</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i> <i>Evidencë nr.136.Politikat e UL për Sigurimin e brendshëm te Cilësisë</i> <i>Evidencë nr.137.Procedurat e UL për Sigurimin e Brendshëm te Cilësisë:</i> <i>Evidencë nr.138.Raporti vjetor i NJSBC 2022-2023</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Kuadri rregullator i UL u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të përpara zhvillimit të provimit të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënës; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj, përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC të cilët janë anonim dhe plotësohen online. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit dhe verifikimin e GVJ, në takimet me stafin akademik të programit dhe studentët, evidentohet përfshirja e studentëve në mënyrë periodike në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe gjithashtu të vlerësimit prej tyre të metodave të përdorura gjatë zhvillimit të programit.




	Në UL njësitë kryesore kanë përfaqësuesin e tyre pranë NJSBC. <i>Evidencë nr.57.Formular vlerësimi nga studenti për pedagogun e lendes</i> <i>Evidenca nr.73.Formulari i vlerësimit te performances</i> <i>Evidencë nr.74.Formulari i monitorimit te procesit mësimor te personelit akademik</i> <i>Evidencë nr.138.Raporti vjetor i NJSBC 2022-2023</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra NJSBC referuar dhe rregullores së saj, raporton mbi vlerësimet e mbledhura së pari tek personeli akademik dhe strukturave vendimmarrëse të fakultetit. Këto raporte janë pjesë e diskutimeve brenda departamentit duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. <i>Evidencë nr.58.Raportet mbi pyetësorëve studentorë</i> <i>Evidencë nr.138.Raporti vjetor i NJSBC 2022-2023</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentet</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e RVB dhe nga vizita në institucion në takimet me stafin akademik dhe studentët e programit, GVJ konstatoi analizën e raporteve të vlerësimeve të personelit në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë duke u bërë pjesë e mbledhjeve në departament nëpërmjet diskutimeve konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. <i>Evidencë nr.20.Analiza e Departamentit të Financë Bankë mbi programin e studimit Bachelor në FB 2022-2023</i> <i>Evidencë nr.58.Raportet mbi pyetësorëve studentorë</i> <i>Evidencë nr.138.Raporti vjetor i NJSBC 2022-2023</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UL u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët anonim online të studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni. NJSBC si strukture e posaçme e sigurimit të cilësisë e cila operon në nivel institucional harton periodikisht raportet e saj vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies në institucion			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it , RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në planin strategjik të zhvillimit të UL, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë. Në UL në nivel institucional monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie funksionon NJBSC si hallka kryesore e këtij procesi e cila në bashkëpunim me njësitë kryesore realizon mision e saj të përcaktuar në rregulloren përkatëse në funksion të misionit dhe vizionit të UL <i>Evidencë nr.50.Vendim e Senatit Akademik të UL "Për Manualin NJSBC"</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBC</i> <i>Evidencë nr.136.Politikat e UL për Sigurimin e brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidencë nr.137.Procedurat e UL për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë:</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin dhe studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në UL është ngritur dhe operon NJSBC në nivel institucional me vendim të Senatit Akademik nr.24, datë 21.11.2023 që përfshin 11 anëtarë me përfaqësues nga stafi i njësive kryesore dhe 4 studentë nga çdo fakultet. Në këtë njësi bën pjesë dhe një ekspert i jashtëm. Në mbështetje të kësaj njësie janë politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe një sërë aktesh rregullative të institucionit si, Manuali i brendshëm i Cilësisë, Rregullorja e funksionimit të NJSBC, Procedurat e institucionit për sigurimin e cilësisë etj. <i>Evidencë nr.50.Vendim e Senatit Akademik të UL "Për Manualin NJSBC"</i> <i>Evidencë nr.128. vendim të Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i>




	<i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i> <i>Evidencë nr.136.Politikat e UL për Sigurimin e brendshëm te Cilësisë</i> <i>Evidencë nr.137.Procedurat e UL për Sigurimin e Brendshëm te Cilësisë:</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UL realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, UL është akredituar së fundmi me VBA Nr. 52, datë 27.11.2020 duke plotësuar standardet institucionale. Vlefshmëria e këtij akreditimi ka përfunduar më 14.12.2023 dhe institucioni është në riakreditim. Ndërsa për programin e studimit Bachelor në Financë- Bankë akreditimi i parë me kusht edhe dhënë me urdhrin e MAS nr.24 date 19.01.2016 dhe që më vonë me vendim nr.433 datë 25.08.2016 janë përcaktuar plotësimi i kushteve të akreditimit. <i>Evidencë :Vendimi i akreditimit institucional</i> <i>Evidencë Vendim i MAS mbi akreditimin e programit te studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UL dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjëseve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës. Gjithashtu NJSBC realizon edhe vlerësimin e performances së stafit akademik bazuar në kriteret e përcaktuara duke hartuar dhe raportin vjetor përkatës. <i>Evidencë nr.72.Formulari i vlerësimit te performances te stafit akademik</i> <i>Evidencë nr.74.Raporti i monitorimit te procesit mësimor ne baze semestri.</i> <i>Evidencë nr.57.Formular vlerësimi nga studenti për pedagogun e lendes</i> <i>Evidenca nr.73.Formulari i vlerësimit te performances</i> <i>Evidencë nr.138.Raporti vjetor i NJSBC 2022-2023</i>

	<i>Evidencë nr.141. Kriteret mbi bazën e te cilave realizohet vëzhgimi i stafit akademik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në UL procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, UL ka marrë akreditimin institucional në vitin 2020 dhe tashmë është në proces riakreditimi. Edhe vete ky program studimi është proces riakreditimi.</i> <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstatoi nga RVB dhe dokumentacioni i aplikimit pranë ASCAL it, se në Fakultetin Ekonomik, përdoren metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Njesisë Kryesore, analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve. Lektorët çdo vit dorëzojnë të drejtuesi i njesisë formularët e raporteve të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. UL përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit. Raportet e analizës mësimore shkencore të Departamentit të FB që mbulon këtë program pas analizës në këtë njësi janë pjesë e raporteve të njesisë kryesore FE dhe të institucionit. <i>Evidencë nr. 20. Analize e Departamentit FB për programin e studimit</i> <i>Evidencë nr. 73. Raportet vjetore te NJSBC</i> <i>Evidencë nr.132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik GVJ gjate vizitës në Institucion</i>

Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi nga RVB se në nivel institucional, NJSBC realizon çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UL-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. Megjithatë raportet si të NJSBC, FE apo Departamentit të FB janë të plota me tabela statistikore por të paplota me analizën e tyre. <i>GVJ rekomandon që në raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik si dhe vlerësimit të performancës të këtij stafi të jenë më të detajuara duke analizuar "kapërcyer" thjesht tabelat statistikore" të cilat janë të plota dhe sidomos me analizë të mangësive të mundshme të dalë nga ky proces.</i> <i>Evidencë nr. 20. Analize e Departamentit FB për programin e studimit</i> <i>Evidencë nr. 73. Raportet vjetore te NJSBC</i> <i>Evidencë nr.132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik</i> <i>GVJ gjate vizitës në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i aplikimit pranë ASCAL dhe RVB-së në nivel institucional është hartuar nga NJSBC dhe është miratuar paketa e instrumenteve matës të cilësisë në UL. Në fund të vitit bëhet vlerësimi i pedagogëve duke u mbështetur në këtë paketë të vlerësimit të performancës. Përpos iniciativës së përmendur, metoda e drejtpërdrejtë e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies është pyetësori i studentëve në fund të çdo semestri. Analiza e raporteve të pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e departamentit. Gjithashtu lektorët në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme dorëzojnë në departament CV-të e rifreskuara. NJSBC monitoron dhe vlerëson edhe elementet e ngarkesës mësimore në auditor, rezultatet e studentëve në testet e vitit dhe atë final, ndjekjen e praktikës etj. <i>Evidencë nr. 73. Raportet vjetore te NJSBC</i> <i>Evidencë nr.74.Raporti i monitorimit te procesit mësimor ne baze semestri.</i> <i>Evidencë nr.132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik</i> <i>Evidencë nr.143.Te dhëna statistikore lidhur me rezultatet e studenteve</i> <i>GVJ gjate vizitës në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Bazuar në informacionin e aplikimit pranë ASCAL dhe RVB, ne konstatuam se UL përdor metoda indirekte të vlerësimit lidhur me matjen e cilësisë, e miratuar në vitin 2022, ku bëjnë

cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	pjesë: Pyetësorë për studentët mbi lëndën dhe pedagogun që e zhvillon atë, formularin e performancës së pedagogut dhe veprimtarinë e tij, vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu; GVJ vlerëson këto metoda të përdorura të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit Bachelor në Financë Bankë. <i>Evidencë nr.72.Formulari i vlerësimit të performances te stafit akademik</i> <i>Evidencë nr.74.Raporti i monitorimit te procesit mësimor ne baze semestri.</i> <i>Evidencë nr.132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik</i> <i>Evidencë nr.143.Të dhëna statistikore lidhur me rezultatet e studenteve</i> <i>GVJ gjatë vizitës në Institucion</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UL parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni NJSBC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UL përmirëson në vazhdimësi kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. GVJ rekomandon që në raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik si dhe vlerësimit të performancës të këtij stafi të jenë më të detajuara duke përfshirë analiza më të plota të tabelave statistikore me qëllim të evidentimit të mangësive të mundshme të dalë nga ky proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacion e aplikimit pranë ASCAL dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UL, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. <i>Evidencë nr.128. vendim te Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në Manualin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UL, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UL. <i>Evidencë nr.128. vendim te Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit	GVJ vlerëson se UL garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. NJSBC përbëhet nga anëtarë nga personeli akademik, përfaqësues të njësive kryesore dhe studentët përkatës të këtyre njësive. Edhe në hartimin e RVB krahas anëtarëve staf




akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	akademik të programit studentët dhe personeli ndihmës akademik janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi. <i>Evidencë nr.128. vendim te Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i> <i>RVB për programin e studimit</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në nivel institucional është ngritur Njësia e Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik student për çdo njësi kryesore si dhe ekspert i jashtëm të cilët kanë integritetin e duhur akademik duke shmangur kështu çdo lloj diskriminimi apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve. <i>Evidencë nr.128. Vendim te Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBC</i> <i>RVB për programin e studimit</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UL angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç edhe e kemi theksuar më lartë në përbërjen e NJSBC ka ekspertë të jashtëm që njohin fushën e ekonomisë dhe financës. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UL dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit. <i>Evidencë nr.128. vendim te Senatit Akademik nr.24, date 21.11.2023 për krijimin e NJSBC</i> <i>Evidencë nr.135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC</i> <i>GVJ gjatë vizitës në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UL përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe</i>




	të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UL realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin përkatës të aplikimit si dhe të takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UL parashikon publikimin e politikave, strategjive, raporteve të ndryshme dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. UL përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email, njoftime në televizion (news 24) dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi si dhe guida e institucionit . <i>Evidentim nga GVJ te publikimeve dhe informacionit qe UL jep ne faqen zyrtare dhe rrjetet sociale</i> <i>Evidencë nr. 73. Raportet vjetore te NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare web të UL dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare web të UL dhe komunikimeve në platformën Pitagora. <i>Evidentim nga GVJ te publikimeve dhe informacionit qe UL jep në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik, raportet përcillen nga NJSBC në njësinë bazë të programit DFB dhe FE. Raportet pasi u bëhen me dije personelit, diskutohen duke ndarë praktikën e mira dhe duke marrë masa

mangësive e dobësive të evidentuara.	për përmirësim të vazhdueshëm mbi problematikat e evidentuara. <i>Evidencë nr.20. Analiza e DFB mbi programin e studimit Bachelor në FB</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UL realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. <i>Evidencë nr.20. Analiza e DFB mbi programin e studimit Bachelor në FB</i> <i>Vizita në Institucion e GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme. Aktivitetet si Panairi i Punës, takime të hapura etj. të publikuara dhe në faqen zyrtare të UL apo TV kanë objektiv kryesorë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës. <i>Vizita në Institucion GVJ dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.</i> <i>Evidenca nr.65. Modul trajnimi akademik Writing Skills</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UL publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	JoK	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Përfundime të Vlerësimit të i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Financë-Bankë" ofruar nga Universiteti "Luarasi"

Pikat e forta dhe afirmime

Grupi i ekspertëve të jashtëm konkludon se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë", ofruar nga Universiteti "Luarasi" ka pika të forta, të tilla si:

1. Universiteti "Luarasi," së bashku me njësinë kryesore dhe bazë që drejtojnë këtë program studimi, gëzojnë një reputacion dhe imazh pozitiv në vend.
2. Studentët e këtij programi studimi janë të motivuar dhe ndjekin me interes të lartë procesin mësimor, duke krijuar marrëdhënie të mira komunikimi me stafin akademik dhe ndihmës. Gjithashtu, ata demonstrojnë një bashkëpunim të frytshëm gjatë gjithë periudhës së studimeve.
3. Vendndodhja e institucionit, e kombinuar me strategjitë efektive të marketingut që ai zhvillon, përbën një faktor pozitiv që rrit atraktivitetin e tij në përthithjen e studentëve të interesuar për këtë program studimi.
4. Universiteti "Luarasi" ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private, si edhe me sipërmarrje të ndryshme. Këto marrëveshje ofrojnë mundësinë e përfitimit të eksperiencës nga specialistë të fushës jashtë institucionit dhe lehtësojnë realizimin e praktikës profesionale për studentët.
5. Universiteti ka krijuar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi dhe programesh shkëmbimi me universitete të tjera dhe partnerë ndërkombëtarë.

Pika të dobëta

1. Mungesa e reflektimit të zhvillimeve në tregun financiar dhe bankar në programin mësimor, veçanërisht në lëndët karakterizuese të programit.(**Standardi II.3, Konkluzione**).
2. Numri i ulët i PAE pengon sigurimin që mbi 70% e ngarkesës mësimore të realizohet nga ky personel. Gjithashtu, UL të bëjë përpjekje për të pasur PAE me staf akademik më të kualifikuar, të cilët të zotërojnë tituj akademikë si Prof. Dr. ose Prof. Asoc. Dr. në procesin e mësimdhënies për këtë program studimi.(**Standardi IV.1, Kriteri 2, Standardi IV.1, Kriteri 1, Standardi II.2, Kriteri 1**.)
3. Praktika profesionale në planin mësimor, duke pasur parasysh rëndësinë e saj në kuadrin e përgjithshëm të programit, është planifikuar me një numër të kufizuar kreditesh dhe një ngarkesë të reduktuar orësh për realizimin e saj.(**Standardi II.1, Kriteri 4**).
4. Mungon studimi i plotë i tregut të punës, me fokus në mundësitë e punësimit në sektorët e financës, bankës, sistemit tatimor dhe doganor, si dhe kontabilitetit, për studentët e këtij programi.(**Standardi II.5, Kriteri 1, dhe 3**).
5. Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Financë-Bankë, ka një fond të limituar të botimeve dhe artikujve shkencorë në funksion të këtij program studimi.(**Standardi IV.3, Kriteri 4**).

6. Në sekretarinë mësimore u vërejtën parregullsi në mbajtjen e procesverbaleve për disa korrigjime në regjistrin themeltar. (Standardi IV.4, Kriteri 1).
7. Alumni ndihmon në analizën e të dhënave, por mbetet nevoja për të plotësuar informacionin mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve i cili mungonte. (Standardi V.4, Kriteri 5).
8. Raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik, që përgatiten nga NJSBC, si dhe vlerësimi i performancës së këtij stafi, duhet të jenë më të detajuara. Ato duhet të përfshijnë analiza më të plota të tabelave statistikore, me qëllim evidentimin e mangësive të mundshme që mund të dalin nga ky proces. (Standardi VI.3, Kriteri 2).

Rekomandime

1. Rekomandojmë që në këtë program të bëhen ndryshime të mundshme të paktën brenda kufirit 20 % që është kompetencë e institucionit. Në këtë kontekst në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mësimnxënies nga ana e studentëve dhe të reflektohen ndryshimet në tregun e punës dhe zhvillimeve ekonomiko-financiare.
2. Rekomandojmë që institucioni duhet të synoj të rrisë numrin e PAE dhe për të siguruar që mbi 70% e ngarkesës mësimore të realizohet nga ky personel, gjithashtu edhe rritjen e numrit të PAE me staf akademik më të kualifikuar që të zotërojnë tituj akademik Prof. Dr. apo Prof.Asoc.Dr. gjë që do i shërbejë edhe për të mbuluar programet e studimit të nivelit të dytë Master.
3. Rekomandojmë që të shtohen kreditet dhe ngarkesa e orëve për realizimin e praktikës profesionale në planin mësimor të këtij programi.
4. Rekomandojmë realizimin e një studimi të plotë të tregut të punës, me fokus në mundësitë e punësimit në sektorët e financës, bankës, sistemit tatimor dhe doganor, si dhe kontabilitetit, për studentët e këtij programi.
5. Rekomandojmë që të shtohet fondi fizik i bibliotekës me literaturë bashkëkohore, si dhe të përfshihen leksione shtesë me literaturë të përgatitur nga pedagogët e këtij programi, për të plotësuar boshllëqet e literaturës së vjetër.
6. Rekomandojmë që raportet e vlerësimit nga studentët për stafin akademik, që përgatiten nga NJSBC, si dhe vlerësimi i performancës së këtij stafi, të jenë më të detajuara. Ato duhet të përfshijnë analiza më të plota të tabelave statistikore, për të mundësuar evidentimin e mangësive të mundshme që mund të dalin nga ky proces.

Conclusions of the Evaluation of the First Cycle Bachelor Study Program in "Finance-Banking" at LUARASI University.

Strengths and Affirmations

The external expert group concludes that the First Cycle Bachelor Study Program in "Finance-Banking" offered by Luarasi Private University possesses several strengths, including:

1. Luarasi Private University, along with the core unit managing this study program, enjoys a strong reputation and a positive image within the country.
2. Students enrolled in this program are highly motivated, actively engage in the teaching process with great enthusiasm, and maintain effective communication with both academic and administrative staff. Additionally, they demonstrate productive collaboration throughout their studies.
3. The university's advantageous location, coupled with well-executed marketing strategies, enhances its attractiveness, and successfully draws prospective students to the program.
4. The university has established numerous cooperation agreements with public and private institutions, as well as various enterprises. These partnerships provide students with valuable opportunities to gain practical experience from industry professionals and engage in professional internships.
5. The university has signed a substantial number of cooperation agreements and exchange programs with other universities and international partners, broadening opportunities for academic and professional growth.

Weaknesses

1. The curriculum does not adequately reflect developments in the financial and banking markets, particularly in the program's core subjects. **(Standard II.3, conclusions).**
2. The low number of full-time academic staff (PAE) hinders the institution's ability to ensure that over 70% of teaching loads are carried out by such personnel. Additionally, there is a need to hire more highly qualified academic staff with titles such as Prof. Dr. or Assoc. Prof. Dr. for this program. **(Standard IV.1, criterion 2, Standard IV.1, criterion 1, Standard II.2, criterion 1.)**
3. The professional practice in the curriculum, considering its importance within the general framework of the program, has been planned with a limited number of credits and a reduced workload of hours for its implementation. **(Standard II.1, criterion 4).**
4. There is a lack of a comprehensive study of the labour market, focusing on employment opportunities in the sectors of finance, banking, taxation, and customs systems, as well as accounting, for the students of this program. **(Standard II.5, criterion 1, and 3).**
5. The Bachelor's program in "Finance-Banking" has a limited collection of publications and scientific articles related to this study program. **(Standard IV.3, criterion 4).**



6. Irregularities were observed in the secretary office regarding the maintenance of the minutes for some corrections in the primary register. **(Standard IV.4, criterion 1).**
7. Alumni data on graduate employment levels is incomplete and requires further development. **(Standard V.4, criterion 5).**
8. Evaluation reports prepared by NJSBC (Quality Assurance Unit) for academic staff performance should be more detailed, including thorough analyses of statistical tables to identify potential shortcomings. **(Standard VI.3, criterion 2).**

Recommendations

1. Introduce curriculum changes within the allowable 20% limit to better meet student learning objectives and reflect changes in the labour market and economic-financial developments.
2. Expand the number of full-time academic staff to ensure that over 70% of teaching loads are carried out by such personnel. Additionally, recruit highly qualified academic staff with titles such as Prof. Dr. or Assoc. Prof. Dr. to enhance both bachelor's and master's level programs.
3. Increase the credits and hours allocated to professional practice in the curriculum.
4. Carry out a detailed labour market study focused on employment opportunities in finance, banking, taxation, customs, and accounting sectors for this program's graduates.
5. Enrich the library's physical collection with contemporary literature and incorporate additional materials prepared by program lecturers to address gaps in outdated literature.
6. Ensure that evaluation reports prepared by "NJSBC" for academic staff performance are more detailed and include comprehensive statistical analyses to identify potential shortcomings effectively.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

